



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 272 Akti

Nr. 469 Vendimi
Tiranë, më 1.11.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 25.10.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ardian Braho**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç, dhe nenet D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Ardian Braho, me detyrë prokuror në Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 19.1.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Trupi gjykues i shortuar për të shqyrtuar çështjen përbëhet nga komisionerët: Suela Zhegu me cilësinë e relatores dhe Alma Faskaj dhe Lulzim Hamitaj, anëtarë të tij. Komisioni, me vendimin nr. 18, datë 9.3.2020, për arsye objektive të komisioneres Alma Faskaj, ka vendosur me short zëvendësimin e saj me komisioneren Genta Tafa (Bungo).

3. Trupi gjykues i përbërë nga komisionerët: Suela Zhegu me cilësinë e relatores, Genta Tafa (Bungo) dhe Lulzim Hamitaj i mbledhur në datën 16.3.2020, në mbledhjen e parë, caktuan me mirëkuptim kryesues të trupit gjykues znj. Genta Tafa (Bungo). Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Tonci Petkovic. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Në datën 5.10.2021 subjekti u njoftua për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ.

4. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, si dhe veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

6. **Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)**, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin financiar pasurive;*
- *nuk kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*

¹Me shkresën me nr. *** prot., datë 29.3.2018.

➤ *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

7. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar²(DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar.

8. Këshilli i Lartë Prokurorisë (KLP)³ ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016 dhe pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

9. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

10. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 5.10.2021, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht duke u bazuar në të tria kriteret: në vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Ardian Braho, njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, rezultatet paraprake të hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

11. Për një proces të rregullt ligjor subjektit të rivlerësimit i janë garantuar të drejtat, si: njoftimi për fillimin e procedurës së rivlerësimit; njoftimi mbi përbërjen e trupit gjykues; dhe për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës mbi rezultatet e hetimit. Në datën 5.10.2021, subjektit iu dërguan rezultatet paraprake të hetimit administrativ dhe iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

12. Z. Ardian Braho, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat në datën 19.10.2021. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit, deklaroi se nuk është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni.

13. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe të provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

14. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e kryer elektronikisht në datën 20.10.2021. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 25.10.2021, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic.

15. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti nuk pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

²Me nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 12.12.2019, të KDZh-së.

³Me shkresën nr. *** prot., datë 15.5.2020.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Subjekti i rivlerësimit Ardian Braho, ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, z. Ardian Braho, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

17. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

18. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20. Ndërsa, sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private;
- e) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP;
- g) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, me burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, mundësitë për fshehje të pasurisë, deklaram të rremë apo konfliktin e interesit.

Në deklaratën e pasurisë *Vetting* (shtojca 2), dorëzuar në ILDKPKI, në datën 24.1.2017, subjekti ka deklaruar pasuritë në vijim:

1. Apartament në pronësi të babait të subjektit, me sip. 91.93 m², me vendndodhje rruga “A. L”, ish-Fusha e Aviacionit, Tiranë, blerë në vitin 2001

Vlera e deklaruar: 3.300.000 lekë.

Mënyra e fitimit: me kontratë shitje nr. ***, datë 4.8.2001.

Burimi i krijimit:

1. Të ardhurat e përfituara si emigrant në Greqi, përgjatë periudhës kohore 1992 – 2001 (nuk disponon dokumentacion përkatës), si i vetëpunësuar në sektorin privat, pa shpëputje nga shkolla e lartë (nuk disponon dokumentacion përkatës), në funksionin e Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Të ardhurat e përfituara nga babai, përgjatë periudhës kohore të viteve 1991 – 2001, në detyrën e ushtarakut në qytetin e Shkodrës (nuk disponon dokumentacion përkatës), si dhe nga pensioni i parakohshëm.
3. Të ardhurat e përfituara nga nëna, përgjatë periudhës kohore 1991 – 2001, në sektorin shtetëror në ndërmarrjen e NFP-së Shkodër (nuk disponon dokumentacion përkatës), si dhe e vetëpunësuar në sektorin privat (nuk disponon dokumentacion përkatës).
4. Një depozitë kursimesh në Bankën e Kursimeve në emër të babait.
5. Të ardhura nga shitja e një apartamenti me sipërfaqe prej 59 m², me vendndodhje në adresën lagjja “S.H”, rruga “A.K”, pall. nr. ***, Shkodër, përfitur nga procesi i privatizimit të banesave në vitin 1993, pasqyruar në kontratën e shitjes nr. ***, datë 17.4.2001.

Në deklaratën *Vetting*, apartamenti është deklaruar në bashkëpronësi me prindërit.

Në DPV-në e vitit 2004 nuk është deklaruar burimi i krijimit për blerjen e apartamentit.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin si vijon:

- kontratë shitjeje nr. ***, datë 4.8.2001, me palë shitëse shoqërinë “Y.Y. A.D & C.LTD” dhe palë blerëse z. E.B, për blerjen e apartamentit 3+1, me sip. 91.93 m², në adresën godina nr. *, kati **, ap. **, Tiranë, në vlerën 3.300.000 lekë. Bashkëlidhur kontratës ndodhet vërtetimi nga dokumentet hipotekor me nr. ***, datë 2.7.2001;
- kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 17.4.2001, me palë shitëse E.B, S.B, E.B, Ardian Braho dhe blerës Y.S, për shitjen apartamentit me sip. 59 m², ndodhur në lagjen “S.H”, rruga “A. K”, pall. ***, në katin e parë, Shkodër, në vlerën 800.000 lekë. Bashkëlidhur kontratës ndodhet vërtetimi nga dokumentet hipotekor me Nr.***, datë 22.06.1994.

1.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga verifikimi i akteve të depozituara, rezultoi se pasuria apartament banimi në pronësi të z. E.B, është blerë nga babai i subjektit përpara se të emërohej në detyrën e prokurorit, më 1.10.2001.

Komisioni ka kërkuar informacion pranë institucioneve si vijon:

ASHK-ja Drejtoria Vendore Tiranë Veri⁴ ka konfirmuar se në emër të babait të subjektit z. E.B, figuron i regjistruar apartamenti me sip. 91.93 m², me nr. pasurie ****+*-**, vol. *, f. **, z. k. **, Tiranë. Bashkëlidhur ndodhet dokumentacioni përkatës i pronësisë së kësaj pasurie, ku dokumentohet sipas kontratës së shitblerjes se apartamenti është blerë nga babai në datën 4.8.2001.

Gjithashtu, nga **ASHK-ja për qytetin e Tiranës**⁵, subjekti i rivlerësimit Ardian Braho dhe personat e lidhur nuk rezultojnë të kenë pasuri të regjistruara në pronësinë e tyre.

OSHEE-ja⁶ identifikon me gjeneralitetet E.B është një kontratë furnizimi në adresën Fusha e Aviacionit, Tiranë, në emër të babait të subjektit, z. E.B.

UKT-ja⁷ ka informuar se nuk rezulton asnjë e dhënë për regjistrim kontrate shërbimi në emër të subjektit dhe familjarëve të tij.

ASHK-ja Drejtoria Vendore Shkodër⁸ ka konfirmuar se apartamenti me sip. 59 m² në Shkodër është shitur përmes kontratës së shitjes nr. **, datë 17.4.2001, nga shtetasit E. B, S. B, E.B dhe Ardian Braho te blerësi Y.S, në vlerën 800.000 lekë, e likuiduar ndërmjet palëve jashtë zyrës noteriale.

Sipas kontratës së shitblerjes, datë 4.8.2001, palët kanë përcaktuar se shuma e blerjes së apartamentit prej 3.300.000 lekësh do të likuidohej *cash* nga blerësi brenda datës 2.8.2001, jashtë zyrës noteriale.

Nga hetimi ka rezultuar se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë apartament të blerë nga babai E.B, para emërimit të tij në detyrën e prokurorit.

Referuar dokumentacionit ligjor, babai figuron pronar i vetëm i ligjshëm i kësaj pasurie.

1.2 Komisioni analizoi burimet e krijimit të pasurisë apartament

a) Në lidhje me burimin 1, të ardhurat e subjektit si emigrant në Greqi, përgjatë periudhës 1992 – 2001, si i vetëpunësuar në sektorin privat, pa shikëputje nga shkolla e lartë, në funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Dokumentacioni i administruar në dosje mbi të ardhurat e subjektit nga paga si vijon:

- vërtetim nr. ** prot., datë 24.10.2016, i Shkollës së Magjistraturës, i dorëzuar në ILDKPKI, ku të ardhurat e subjektit, për periudhën 1998 – 2000, janë në shumën 441.810 lekë;
- vërtetim, datë 13.10.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i dorëzuar në ILDKPKI, ku të ardhurat e subjektit, për periudhën tetor 2000 – 2001, janë në shumën 507.212 lekë

⁴Shkresë nr. ** prot., datë 21.10.2019.

⁵Shkresat nr. ** prot., datë 18.10.2019, të Drejtorisë Vendore Tiranë Jug dhe nr. ** prot., datë 23.10.2019, të Drejtorisë Vendore Tiranë Rurale 2.

⁶Shkresë nr. ** prot., datë 15.10.2019.

⁷Shkresë nr. k-** prot., datë 11.10.2019.

⁸Shkresë nr. ** prot., datë 8.11.2019.

Subjekti ka shpjeguar⁹ se: “Kontributi për blerjen e kësaj pasurie ka qenë i prindërve nga puna përgjatë periudhës kohore të viteve 1991 – 2001. Ndërsa kontributi i tij ka qenë pothuajse i pakonsiderueshëm, duke përfshirë këtu punën në Greqi për disa muaj në vitin 1993 apo edhe nga aktiviteti tregtar në tregun e lirë privat, kryesisht në periudhën e pushimeve gjatë shkollimit, për të cilat nuk disponon dokumentacion”.

Nga verifikimi i akteve lidhur me këtë burim, subjekti nuk ka dokumentuar të ardhurat e përfituara si emigrant në Greqi, për periudhën 1992 – 2001 dhe si i vetëpunësuar në sektor privat pa shkëputje nga shkolla e lartë.

b) Në lidhje me burimin 2, të ardhurat e përfituara nga babai, përgjatë periudhës 1991 – 2001, nga punësimi si ushtarak në qytetin e Shkodrës, si dhe nga pensioni i parakohshëm. Dokumentacioni i administruar në dosje, lidhur me të ardhurat e babait të subjektit, si vijon:

- kopje e librezës së punës së z. E.B, ku reflektohet kryerja e detyrës së ushtarakut për periudhën 1966 – maj 2001, si dhe trajtimi me pagesë kalimtare nga 1 qershor 2001 – 1 qershor 2003;
- vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare të lëshuar nga ISSH-ja, ku të ardhurat e realizuara nga z. E.B si ushtarak për vitin 1996 janë në shumën totale 80.952 lekë;
- vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare të lëshuar nga ISSH-ja, ku të ardhurat e realizuara nga z. E. B si ushtarak, për periudhën mars 1997 – maj 2001, janë në shumën totale 455.074 lekë;
- vërtetim (për kontributet e sigurimeve shoqërore), datë 13.6.2006, nga ISSH-ja Drejtoria Rajonale Shkodër, ku kontributet e derdhura për z. E.B si ushtarak, për periudhën janar 2001 – maj 2001, janë në shumën 30.375 lekë;
- vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare të lëshuar nga ISSH-ja, ku pagesat kalimtare të përfituara z. E.B, për periudhën qershor 2001 – qershor 2003, janë në shumën totale 242.811 lekë;
- modular për efekt pensioni, vjetërsie shërbimi invaliditeti ose familjar me nr. *** prot., datë 10.4.2006, lëshuar nga Komanda e Repartit Ushtarak, e cila konfirmon ndërprejren e të drejtave administrative të z. E.B më 31.5.2001 dhe aktverifikimi i mbajtur në datën 15.6.2006, nga ISSH-ja për vjetërsinë në punë të z. E.B.

c) Në lidhje me burimin 3, të ardhurat e përfituara nga nëna, përgjatë periudhës 1991 – 2001, në sektorin shtetëror në ndërmarrjen e NFP-së Shkodër, si dhe e vetëpunësuar në sektorin privat. Dokumentacioni i administruar në dosje mbi të ardhurat e nënës së subjektit janë si vijon:

- kopje e librezës së punës ku reflektohet punësimi i znj. S.B: për periudhën 1971 – 1991, në NFP V.D; për periudhën 1992 – 1995, pranë Degës së Sigurimeve Shoqërore Shkodër; si dhe në periudhën 1995 – 1996, pranë Zyrës së Punësimit Shkodër;
- vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare e lëshuar nga ISSH-ja, ku të ardhurat e realizuara nga znj. S.B nga punësimi pranë DRSSH-së Shkodër, për periudhën tetor 1992 – mars 1995, janë në shumën totale 47.010 lekë.

Për sa i përket punësimit të nënës në sektor privat, subjekti ka shpjeguar¹⁰ se nëna ka punuar si subjekt privat, bar-kafe, në ambientet e uzinës mekanike “D”, në fshatin Rr, Sh, aktivitet privat për të cilin nuk disponon dokumentacion, pasi nuk ka qenë e regjistruar.

⁹Shpjegimet e subjektit me e-mail datë 2.7.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 25.6.2021.

¹⁰E-mail datë 2.7.2021.

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me këtë burim, është evidentuar mungesë dokumentacioni justifikues mbi të ardhurat e nënës të përfituara si e vetëpunësuar në sektor privat dhe, si të tilla, nuk janë përfshirë në analizë financiare.

- d) Në lidhje me burimin 4, subjekti¹¹ ka deklaruar një depozitë kursimesh në Bankën e Kursimeve në emër të babait, duke shpjeguar se : *“Në datën 30.9.2000 babai ka pasur të depozituar shumën 1.031.176 lekë, e cila është tërhequr dy herë dhe mbajtur fizikisht në banesë deri në datën 28.3.2001”*.

Subjekti ka dokumentuar këtë depozitë kursimesh me shkresën nr. *** prot., datë 6.5.2021, të “Raiffeisen Bank”, ku vërtetohet gjendja e depozitave të kursimit të z. E.B në ish-Bankën e Kursimeve, në vitet 1997 – 2000, e cila ndryshon si rrjedhojë e interesave bankare të përfituara gjatë çdo periudhe 3-mujore, si dhe derdhjeve dhe tërheqjeve që janë kryer në këtë depozitë.

- e) Në lidhje me burimin 5, të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 59 m², me vendndodhje në Shkodër, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 17.4.2001, me palë shitëse shtetasit E. B, S.B, E.B dhe Ardian Braho dhe blerës shtetasin Y.S, janë në shumën 800.000 lekë.

Subjekti ka depozituar dokumentacion¹² provues lidhur me pasurinë apartament në Shkodër.

Referuar akteve të dërguara nga ASHK-ja Shkodër¹³, ky apartament është përfituar nga subjekti dhe familjarët e tij, përmes procesit të privatizimit të banesave në vitin 1993 nga Ndërmarrja Komonale Banesa Shkodër.

Për sa i përket çmimit të shitjes së apartamentit në Shkodër, subjekti pretendon¹⁴ se: *“...çmimi i shitjes në kontratën e shitjes, datë 17.4.2001, është pasqyruar në vlerën 800.000 lekë, por në realitet shuma e shitjes së apartamentit është në vlerën prej 1.400.000 lekë”*.

Subjekti ka paraqitur si dokumentacion justifikues deklaratë noteriale¹⁵, datë 4.5.2021, përmes së cilës blerësi i apartamentit z. Y.S deklaroi se: *“Këtë banesë e ka blerë realisht 1.400.000 lekë dhe jo 800.000 lekë siç është pasqyruar në kontratën e shitjes në datën 17.4.2001 dhe këtë shumë blerësi ia ka dorëzuar në dorë z. E.B”*.

Në lidhje me pretendimet e subjektit mbi çmimin real të shitjes së apartamentit në Shkodër në datën 17.4.2001, Komisioni ka kryer një verifikim mbi vlerën e tregut të lirë të banesave referuar çmimit të EKB-së¹⁶, ku rezultoi se për apartamentet e ndodhura në Shkodër, çmimi në tregun e lirë në vitin 2001 ishte 38.087 lekë/m². Referuar çmimit të EKB-së, për

¹¹Shpjegimet e subjektit datë 7.5.2021 në përgjigje të pyetësorit datë 19. 4.2021.

¹²Në përgjigje të pyetësorit datë 19.4.2021, subjekti ka dërguar dokumentacionin si vijon, protokolluar me nr. *** prot., datë 7.5.2021: certifikatë për vërtetim pronësie datë 3.5.2001, të ZVRPP-së Shkodër; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 17.4.2001; vërtetim nga dokumenti hipotekor datë 17.4.2001, të ZVRPP-së Shkodër dhe hartë treguese e pasurisë, të njehsuara me origjinalin nga noteri më 3.5.2021; deklaratë noteriale nr. ***, datë 4.5.2021, e shtetasit Y. S.

¹³Shkresë nr. *** prot., datë 8.11.2019, ASHK-ja Shkodër ka dërguar dokumentacionin: kartela e pasurisë së paluajtshme nr. **+*_* (apartament me sip. 59 m²); kërkesë për privatizim banese; certifikatë e përbërjes familjare; formulari nr. * treguesit kryesorë për apartamentin; vërtetim datë 25.9.1978 i Ndërmarrjes së Banësve Shkodër; autorizim datë 8.9.1977; akti i dhënies dhe marrjes në dorëzim të banesës shtetërore datë 16.8.1978; raport teknik nr. *, datë 14.9.1978; planimetri e apartamentit; deklaratë personale datë 1.5.2001; kontratë shitje nr. ***, datë 17.4.2001; vërtetim nga dokumentet hipotekore nr. ***, datë 22.6.1994, mandatar-këtime; kontrata për privatizimin e banesës datë 13.9.1993 ndërmjet NK Banesa dhe E. B; akti i shitblerjes datë 21.6.1994 të nënshkruar ndërmjet Sektorit të Privatizimit të Banësve dhe shtetasve E.B, S.B, E.B dhe Ardian Braho.

¹⁴E-mail datë 7.5.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 19.4.2021.

¹⁵Deklaratë noteriale nr. ***, datë 4.5.2021.

¹⁶Referuar udhëzimit nr. 5, datë 31.5.2001, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banësve nga EKB-ja, të vlerave në tregun e lirë të banësve dhe të koeficientit K”.

apartamentin me sip. 59 m² vlera do të ishte 2.247.133 lekë, ndërkohë që sipas kontratës së shitjes së datës 17.4.2001, çmimi i shitjes së apartamentit referon vlerën prej 800.000 lekësh, ku duket shumë më i ulët nga sa referon udhëzimi nr. 5, datë 31.5.2001.

Duke qenë se shitja e apartamentit në Shkodër ka shërbyer, ndër të tjera, si burim për blerjen e apartamentit në Tiranë, Komisioni ka kryer analizën financiare, duke marrë në konsideratë çmimin e shitjes së apartamentit në shumën 800.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes.

Sa më sipër, në analizë financiare janë marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e dokumentuara, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore dhe jo sa pretendon subjekti, në përputhje me pikën 3, të nenit D, Aneksit të Kushtetutës.

1.3 Analiza financiare

Komisioni kreu analizën financiare për të vlerësuar mundësinë dhe burimet e ligjshme të blerjes së kësaj pasurie nga babai i subjektit, z. E.B, me të ardhurat familjare, si vijon:

- të ardhurat e babait, për periudhën 1991 – 2001, si ushtarak dhe pagesa kalimtare;
- të ardhurat e përfituara nga nëna, për periudhën 1991 – 2001;
- depozitë kursimesh në Bankën e Kursimeve, ku evidentohet në datën 30.9.2000, ka pasur shumën 1.031.176 lekë, e cila është tërhequr dhe mbajtur fizikisht në banesë¹⁷ deri në datën 28.3.2001;
- të ardhura nga shitja e apartamentit në Shkodër (referuar kontratës shitur në vlerën 800.000 lekë).

Referuar certifikatës familjare¹⁸ motra e subjektit, znj. E.B, ka kryer veçimin nga trangu familjar në vitin 1995 dhe, për rrjedhojë, analiza financiare është kryer mbi burimet e ligjshme të subjektit dhe prindërve të tij.

Analizë financiare, për mundësitë financiare të babait të subjektit për të blerë apartamentin

Përshkrimi	Periudha 1991-2001
Të ardhura	2 037 117
Të ardhurat e babait të subjektit për vitet 1996 – 2001	595 939
Të ardhura të tërhequra nga depozita në “Raiffeisen Bank”	1 031 176
Të ardhurat e nënës së subjektit për vitet 1991 – 2001	47 101
Të ardhurat e subjektit (bursa)	594 077
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Shkodër	800 000
Shpenzime	1 048 700
Shpenzime jetese	1 048 700
Pasuri	3 300 000
Pasuria apartament	3 300 000
Rezultati financiar	- 1 280 407

Nga analiza e kryer për apartamentin në pronësi të babait të blerë në datën 4.8.2001, përpara se subjekti të emërohej në detyrën e prokurorit, rezulton me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme, në shumën 1.280.407 lekë.

¹⁷Sipas shpjegimeve të dhëna nga subjekti në datën 7.5.2021 në përgjigjen e pyetësorit datë 19.4.2021.

¹⁸Certifikatë familjare datë 2.6.2021 e Njësisë Administrative Shkodër, e paraqitur nga subjekti më 7.6.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 27.5.2021.

Nga verifikimi i akteve të administruara për këtë pasuri ka rezultuar se:

- a) pasuria apartament në pronësi të babait, është krijuar përpara se subjekti të emërohej në detyrën e prokurorit dhe referuar akteve ligjore, babai figuron pronar i vetëm i ligjshëm i kësaj pasurie;
- b) subjekti ka deklaruar saktë këtë pasuri në deklaratën *Vetting*, e cila përputhet me DPV-në e vitit 2004;
- c) nga analiza financiare duket se ka pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për apartamentin e blerë nga babai, në shumën 1.280 407 lekë.

Në lidhje me pamjaftueshmërinë për blerjen e apartamentit, subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti ka shpjeguar përmes prapësimeve të depozituara në datën 19.10.2021, se burimi i krijimit të këtij apartamenti janë kryesisht kursimet e realizuara prej babait, përpara se subjekti të emërohej në detyrën e prokurorit. Pasuria apartament në pronësi të babait, është blerë në vitin 2001 kryesisht me të ardhurat e tij, të fituara gjatë një periudhe të hershme në kohë, si dhe nga shitja e apartamentit në Shkodër, vlera e së cilës realisht ka qenë 1.400.000 lekë dhe jo 800.000 lekë, siç është përcaktuar në kontratën e shitjes.

Lidhur me shitjen e apartamentit në Shkodër, subjekti është referuar tek konstatimi i Komisionit, ku vlera e apartamentit në Shkodër referuar çmimit të EKB-së për vitin 2001 do të ishte 2.247.133 lekë, çka provon se deklarimi i babait të tij është i besueshëm dhe çmimi real i shitjes së apartamentit ka qenë në vlerën 1.400.000 lekë. Subjekti ka shpjeguar se vlera 800.000 lekë e përcaktuar në kontratë duhet të ketë qenë një lapsus pa asnjë qëllim ndërmjet palëve.

Lidhur me këtë pasuri, subjekti ka prapësuar se në kohën kur janë përfituar këto të ardhura, babai nuk gëzonte statusin e personit të lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Duke qenë se pasuria është blerë kryesisht me të ardhurat e babait, e vendos subjektin në pamundësi objektive për të provuar plotësisht burimet e ligjshme, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti ka prapësuar se pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme të prindërve për blerjen e kësaj pasurie, nuk duhet ta ngarkojë me përgjegjësi, për shkak se krijimi i të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit nga babai, i takojnë një periudhe të hershme, përpara se subjekti të emërohej në detyrën e prokurorit.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, pasi vlerësoi gjithë dokumentacionin e administruar në dosje, shpjegimet e subjektit, rrethanat dhe faktet e dala gjatë hetimit, si:

- i. Pasuria apartament e blerë nga babai i subjektit është deklaruar saktë në deklaratën *Vetting*, në përputhje me nenin 3/13 të ligjit nr. 84/2016, ku babai cilësohet “person i lidhur” me subjektin e rivlerësimit, si dhe çdo person tjetër i përmendura në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile, për periudhën e rivlerësimit.
- ii. Pasuria apartament e blerë nga babai, përpara se subjekti të emërohej në detyrën e prokurorit.
- iii. Prindërit dhe subjekti nuk kanë qenë të detyruar të ishin të kujdesshëm në mbajtjen dhe ruajtjen e dokumentacionit mbi të ardhurat nga punësimi në sektorë privat apo mbi të ardhurat si emigrant në Greqi apo të ishin të kujdesshëm, lidhur me çmimin e shitjes së apartamentit në Shkodër, të vendosur në kontratën e shitblerjes.

Nisur nga sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se pamjaftueshmëria financiare e rezultuar nga analiza e kryer nga Komisioni, nuk mund të ngarkoj me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, në bazë të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

2. Apartament në pronësi të babait të subjektit, me sip. 53 m², në të njëjtën adresë, në Tiranë, blerë në vitin 2007

Vlera e deklaruar: 3.000.000 lekë.

Zotërimi: 100% në pronësi të babait.

Në deklaratën *Vetting*: deklaruar në bashkëpronësi me të gjithë personat sipas certifikatës familjare.

Burimi i krijimit:

1. Të ardhurat e përfituara nga paga në funksionin e prokurorit.
2. Të ardhurat nga babai nga pensioni i parakohshëm, pensioni suplementar dhe pensioni i pleqërisë, si dhe të ardhurat e përfituara nga punësimi në sektor privat.
3. Të ardhura nga nëna nga pensioni i pleqërisë, si dhe nga punësimi i saj në sektorin privat.

Mënyra e fitimit: me kontratë shitje nr. ***, datë 16.8.2007.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës kontratën e shitjes nr. ***, datë 16.8.2007, me palë shitëse shtetasit A.R dhe M.R dhe palë blerëse shtetasin E.B për blerjen e apartamentit me sip. 53 m², në ish-Fusha e Aviacionit Civil, Tiranë, në vlerën 3.000.000 lekë.

2.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga verifikimi i akteve të depozituara, u evidentua fakti se kjo pasuri është blerë nga babai i subjektit. Për këtë pasuri u kërkua informacion institucioneve si vijon:

ASHK-ja Drejtoria Vendore Tiranë Veri¹⁹ ka konfirmuar se në emër të shtetasit E.B (babai i subjektit të rivlerësimit) figuron i regjistruar apartamenti me sip. 53.03 m² me nr. pasurie ***+*-*, vol. *, f. **, z. k. ***, Tiranë.

ISSH-ja²⁰ ka dërguar informacion mbi masën e pensioneve të pleqërisë të përfutur nga prindërit e subjektit, ku për nënën pagesat e pensionit nisin nga data 8.5.2004 dhe për babanë e tij pagesat e pensionit nisin nga data 3.4.2006.

Nga hetimi ka rezultuar se apartamenti është blerë nga babai i subjektit, i cili referuar dokumentacionit të pronësisë figuron pronar i vetëm i ligjshëm i kësaj pasurie.

Në kontratën e shitjes, datë 16.8.2007, palët kanë përcaktuar se shuma e blerjes prej 3.000.000 lekësh është likuiduar *cash* nga blerësi jashtë zyrës noteriale.

2.2 Komisioni ka analizuar vlerën e tregut të lirë të banesave referuar çmimit të EKB-së, ku meqenëse për vitin 2007 nuk disponohen të dhëna për çmimet referencë, të ndara sipas zonave të Tiranës, është konsideruar viti 2008, si vit më i afërt për të cilin çmimet përcaktohen sipas zonave. Konkretisht, sipas Udhëzimit nr. 1, datë 20.8.2008, të EKB-së, rezulton se çmimi i referencës për zonën 7/4, në të cilën ndodhet apartamenti objekti shqyrtimi është 65.000 lekë/m². Kështu, për apartamentin me sip. 53 m², vlera do të ishte 3.445.000 lekë (çmimi i blerjes 3.000.000 lekë dhe çmimi i referencës 3.445.000 lekë)

¹⁹Shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2019.

²⁰Shkresë nr. *** prot., datë 3.10.2019.

- ✓ Nga analizimi i akteve sa më sipër ka rezultuar se diferenca ndërmjet çmimit të blerjes së apartamentit është shumë e vogël, krahasuar me çmimin referencë të EKB-së.

Për rrjedhojë, nuk krijohen dyshime mbi çmimin real të blerjes së apartamentit.

2.3 Komisioni hetoi mbi mundësinë e një konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shitësit e apartamentit shtetasit A.R dhe M.R dhe sipas dokumentacionit të administruar në dosje²¹ ka rezultuar se subjekti gjatë ushtrimit të funksionit si prokuror nuk ka pasur çështje penale të hetuara, mosfilluara, pushuara apo dërguara për gjykim me këta shtetas.

2.4 Komisioni analizoi burimet e krijimit të pasurisë

Sipas deklaratës *Vetting*, subjekti ka deklaruar këto burime krijimi, të cilat u analizuan nga Komisioni, si vijon:

- të ardhurat e përfituara nga paga në funksionin e prokurorit;
 - të ardhurat nga babai nga pensioni i parakohshëm, pensioni suplementar dhe pensioni i pleqërisë, si dhe të ardhurat e përfituara nga punësimi në sektor privat.
 - të ardhura nga nëna nga pensioni i pleqërisë, si dhe nga punësimi i saj në sektorin privat.
- i.** Në lidhje me burimin 1, për të ardhurat e përfituara nga paga si prokuror, subjekti ka depozituar dokumentacionin në vijim:
- vërtetim nr. extra prot, datë 30.4.2021, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, ku të ardhurat e përfituara nga shtetasi Ardian Braho, për periudhën tetor 2001 – prill 2004, janë në vlerën 1.592.510 lekë;
 - vërtetim nr. *** prot., N. Z., datë 30.4.2021, lëshuar nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ku të ardhurat e përfituara nga shtetasi Ardian Braho, për periudhën janar 2004 – qershor 2008, janë në vlerën 5.270.749 lekë.
- ii.** Në lidhje me burimin 2, për të ardhurat e babait të subjektit nga pensioni kalimtar, për periudhën qershor 2001 – qershor 2003, pensioni suplementar, duke filluar nga data 1.6.2003 dhe pensioni i pleqërisë duke filluar nga 3.4.2006, si dhe të ardhurat nga punësimi në sektor privat pranë shoqërisë së ruajtjes fizike “****” sh.p.k., në periudhën shtator 2001 – 2003 dhe pranë shoqërisë “N.S.S” (N.S.S) sh.p.k., për periudhën janar 2004 – tetor 2007, subjekti ka depozituar si vijon:
- vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare të lëshuar nga ISSH-ja ku *pagesat kalimtare* të përfituara z. E.B, për periudhën qershor 2001 – qershor 2003, janë në shumën totale 242.811 lekë;
 - vërtetim me nr. *** prot., datë 30.4.2021, i lëshuar nga ISSH-ja, e cila konfirmon masën e pensionit të pleqërisë se z. E.B, në shumën 26.163 lekë/muaj, me datë fillimi 3.4.2006 dhe *pensionin suplementar pleqërie* me masë mujore 10.581 lekë/muaj, me datë fillimi 1.6.2003. Bashkëlidhur ndodhet tabela e llogaritjes së masës së pensionit të pleqërisë dhe suplementar nga data 1.6.2003 dhe pensioni i pleqërisë me datë fillimi 3.4.2006;
 - lidhur me punësimin e babait²² pranë shoqërisë së ruajtjes fizike “****” sh.p.k., me administrator z. S. M, në detyrën e rojes fizike, subjekti ka shpjeguar²³se: “*Babai ka qenë i punësuar në detyrën e punonjësit të sigurisë fizike pranë shoqërisë së ruajtjes*”

²¹Dokumentacion i përcjellë nga subjekti me nr. ***prot., datë 2.7.2021: shkresë nr. *** prot. (Z.M), datë 28.6.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; shkresë nr. *** prot., datë 1.7.2021, e Prokurorisë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; shkresa nr. ***-A prot., datë 1.7.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

²²Subjekti ka depozituar: vërtetim nr. *** prot., datë 6.5.2021, i QKB-së, e cila ka përcjellë dokumentacionin e shoqërisë “****” sh.p.k. me ortak z. S.M, vendim gjykate për regjistrimin e personit juridik, statutin e shoqërisë dhe akt themelimi.

²³Në përgjigje të pyetësorit datë 19.4.2021, mbërritur më 7.5.2021.

fizike 'S.M', me administrator shtetasin S.M, në muajin shtator të vitit 2001 deri në vitin 2003, me të ardhura në shumën rreth 420.000 lekë". Në lidhje me këto të ardhura, subjekti ka deklaruar se nuk disponon dokumentacion provues, pasi administratori i kësaj shoqërie nuk banon më në qytetin e Tiranës dhe nuk ka pasur mundësi të marrë dokumentacion provues;

- lidhur me punësimin e babait pranë shoqërisë së ruajtjes fizike "N.S.S." (N.S.S) sh.p.k., pranë Komisionit janë administruar gjatë hetimit dy shkresa, përkatësisht: shkresa me datë 4.5.2021 (me datë të korrigjuar) dhe shkresa nr. ** prot., datë 30.6.2021, të shoqërisë "N.S.S." (N.S.S) shpk, e cila konfirmon punësimin e z. E.B, si shërbim roje objekteve, në periudhën 1.1.2004 – 30.10.2007, me pagë 20.000 – 25.000 lekë/muaj, për të cilën nuk janë derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore, pasi ka qenë me pension të parakohshëm. Lidhur me këtë punësim, nuk rezulton të jenë derdhur kontribute.

Në deklarin për herë të parë të vitit 2003 (dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI, më 8.6.2004), te rubrika "të ardhura personale nga paga ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura", subjekti ka deklaruar edhe të ardhurat e babait nga punësimi në polici private në vlerën 150.000 lekë, si dhe të ardhurat e pensionit në vlerën 144.000 lekë

Gjithashtu, si provë indirekte për të provuar punësimin e babait, subjekti ka paraqitur dokumentacion²⁴ të marrë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku gjatë një procesi hetimor, babai i subjektit ka dhënë një deklarin, si person i punësuar pranë shoqërisë private të ruajtjes "N.S.S." sh.p.k.

Subjekti ka shpjeguar²⁵ se: "*Për periudhën janar 2004– gusht 2007, në të cilën është blerë apartamenti, babai ka pasur të ardhura në shumën prej 945.000 lekë. Vetëm në momentin e dërgimit të pyetësorëve nga Komisioni, kam ardhur në dijeni të faktit që për punësimin e babait nuk ishin paguar tatimet përkatëse nga ana e administratorit. Kjo ka ndodhur për shkak të faktit se ndërkohë babai përfitonte pensionin kalimtar pleqërie si ushtarak dhe nuk lejohej sigurimi i dyfishtë, sikundër është aktualisht. Nga komunikimi me administratorin, me vullnetin për të deklaruar dhe paguar me vonesë detyrimet e mësipërme, administratori i shoqërisë është treguar i gatshëm që të ndërmarrë çdo veprim për këtë qëllim, pasi të ketë komunikuar me organet tatimore*".

Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga babai nga punësimi në shoqëritë private, të cilat janë në vlerën totale 1.365.000 lekë, ka rezultuar mungesë dokumentacioni mbi pagesat e detyrimeve tatimore për periudhën shtator 2001 – gusht 2007 dhe nuk mund të konsiderohen në analizë financiare si burime të ligjshme.

iii. Në lidhje me burimin 3, për të ardhurat e përfituara nga nëna nga pensioni i pleqërisë me datë fillimi 8.5.2004, si dhe nga punësimi i saj në sektorin privat pranë lokalit bar-kafe "C", për periudhën 2001 – 2007, subjekti ka depozituar dokumentacionin, si vijon:

- vërtetim nr. *** prot., datë 30.4.2021, i lëshuar nga ISSH-ja, i cili konfirmon masën e pensionit të pleqërisë për znj. S.B, në shumën 14.914 lekë/muaj, me datë fillimi 8.5.2004, të ardhurat, për periudhën 8.5.2004 – 30.4.2021, janë në vlerën 2.400.267 lekë (bashkëlidhur ndodhet tabela e llogaritjes së masës së pensionit;

²⁴Subjekti ka paraqitur dokumentacionin si vijon: vërtetim nr. ekstra prot., datë 4.5.2021 dhe shkresë nr. ** prot., datë 30.6.2021, i Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike "N.S.S", Lezhë; ekstrakt historik i regjistrit tregtar për subjektin "N.S.S." sh.p.k.; vendim i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pushimin e procedimit penal nr.***, viti 2007; procesverbal për marrjen e të dhënave nga personat që kanë dijeni për veprën penale datë 6.6.2007.

²⁵Shpjegimet e subjektit me e-mail datë 2.7.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 25.6.2021.

- deklaratë noteriale nr. ***, datë 5.5.2021, e shtetasve E.P dhe V.P, të cilët deklarojnë punësimin e znj. S.B në aktivitetin e tyre privat për periudhën 2001– 2007.

Për sa i përket të ardhurave të nënës, si e punësuar në sektor privat, subjekti ka shpjeguar²⁶ se: *“Nëna ka qenë e punësuar si banakiere në lokalin bar-kafe ‘C’ me vendndodhje në ish-Fusha e Aviacionit, rr. ‘A.L’, me subjekt tregtar Person Fizik ‘B.P’ dhe më pas V. P, nga shtator 2001– 2007, me të ardhura në shumën 1.000.000 lekë”*.

Në lidhje me këto të ardhura subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale²⁷, datë 5.5.2021, përmes së cilës shtetasit z. V.P dhe znj. E.P deklarojnë se: *“Gjatë viteve 2002 – 2010 janë marrë me administrimin e bar-kafe ‘C’, pasi pronari i këtij biznesi, djali i xhaxhait B.P emigroi në Kanada dhe në këtë biznes ka qenë e punësuar znj. S. B si banakiere, e cila shpërblehej në shumën 12.000 lekë/muaj, nga viti 2001 –2007”*.

Gjithashtu, subjekti ka paraqitur shkresën nr. B-***prot., datë 5.5.2021, të Bashkisë Tiranë, përmes së cilës rezulton se aktiviteti bar-kafe, i z.B.P, me NIPT K***Q është regjistruar në sistemin informatik për herë të parë në vitin 2001, dhe aktualisht është me status “aplikim për çregjistrim në datën 26.10.2010.

Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga nëna në shumën 1.000.000 lekë, nga punësimi në sektorin privat, evidentohet mungesë e dokumentacionit mbi pagesat e detyrimeve tatimore, për periudhën 2001–2007 dhe nuk mund të konsiderohen në analizë financiare.

Komisioni në analizën financiare ka marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e dokumentuara, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, në përputhje me pikën 3, të nenit D, Aneksit të Kushtetutës.

2.5 Analiza financiare për apartamentin e blerë në 2007, në pronësi të babait të subjektit

i) Meqenëse në deklaratën *Vetting* dhe deklaratimet periodike vjetore, subjekti ka deklaruar apartamentin si pasuri në bashkëpronësi, Komisioni i ka kërkuar²⁸ subjektit të japë shpjegime shteruese duke saktësuar kontributin e tij në vlerë monetare për blerjen e kësaj pasurie, si dhe pjesën takuese në përqindje.

Subjekti ka shpjeguar në mënyrë të detajuar kontributin dhe të ardhurat e tij dhe të prindërve.²⁹

ii) Për sa i përket pjesës takuese të subjektit mbi këtë apartament, i cili në deklaratën *Vetting*, e ka deklaruar si pasuri në bashkëpronësi, ndër të tjera, subjekti ka shpjeguar³⁰ se: *“Deklarimet*

²⁶Në përgjigje të pyetësorit datë 19.4.2021, mbërritur më 7.5.2021.

²⁷Deklaratë noteriale nr.***, datë 5.5.2021, e shtetasve E dhe V.P, të cilët deklarojnë punësimin e znj. S. B në aktivitetin e tyre privat në vitet 2001 – 2007; bashkëlidhur ndodhet edhe shkresa me nr. B-*** prot., datë 5.5.2021, e Bashkisë Tiranë në shtetasin B.P.

²⁸Përmes pyetësorit me e-mail datë 25.6.2021.

²⁹Shpjegime të subjektit në datën 2.7.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 25.6.2021 mbi kontributin e tij: të ardhurat e përfituara nga paga si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për periudhën 1.10.2001 – 1.4.2004 në shumën 1.592.510 lekë; të ardhurat nga paga si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Renda Tiranë, në periudhën 1.4.2004 – gusht 2007, në shumën 4.151.760 lekë; të ardhurat e babait E.B nga punësimi pranë shoqërisë së ruajtjes fizike “***”, me administrator z. S. M, për periudhën shtator 2001 - dhjetor 2003, në shumën 420.000 lekë; të ardhurat e babait E. B nga punësimi pranë shoqërisë “N.S.S” në periudhën janar 2004 – gusht 2007, në shumën 945.000 lekë; të ardhurat e nënës S.B si e punësuar pranë bar-kafe “C” me administrator z. B.P, për periudhën shtator 2001 – gusht 2007 me të ardhura 900.000 lekë; pension kalimtar dhe pension pleqërie e babait E.B në shumën 26.163 lekë/muaj, ku për periudhën 1.6.2003 – 30.6.2007 ka përfituar pension kalimtar në shumën 737.149 lekë, ndërsa në datat 3.4.2006 – 30.6.2007 ka përfituar pension pleqërie në shumën 225.988 lekë; pension pleqërie të nënës S.B në shumën 14.917 lekë/muaj, ku prej periudhës 8.5.2004 – 30.6.2007 ka përfituar pension pleqërie në shumën 298.153 lekë.

³⁰Me e-mail datë 2.7.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 25.6.2021.

në lidhje me bashkëpronësinë për pasuritë e paluajtshme, ka qenë një opinion i shprehur nga ana ime, duke mos pasur dyshime që në të ardhmen, unë dhe anëtarët e familjes sime do të ishim trashëgimtarë ligjore të këtyre pasurive”.

Në vijim, në lidhje me apartamentin e blerë më 16.8.2007, subjekti ka saktësuar se: *“Nuk jam bashkëpronar i apartamentit në fjalë. Blerja e apartamentit është bërë nga babai, ku unë dhe prindërit e mi kanë kontribuar nga ana financiare me të ardhurat e deklaruara më sipër. Fakti që kam kontribuar, madje konsiderueshëm, nuk më bën bashkëpronar. Kontributi im ka qenë në kuadër të bashkëjetesës në një familje, ku kryefamiljar ka qenë babai im, ku njëkohësisht babai ka qenë edhe menaxhues i të gjitha të ardhurave të familjes, ku shpenzimet e familjes ka qenë vetëm shpenzime jetike. Gjatë gjithë kohës unë kam dorëzuar të ardhurat e mia tek babai, në cilësinë e kryefamiljarit si dhe për shkak të traditës familjare, dhe nuk kam pasur dijeni për mënyrën e menaxhimit të të ardhurave, kryerjen e shpenzimeve apo kursimet nga babai”.*

iii) Nga verifikimi i llogarive të babait të subjektit, është evidentuar një depozitim *cash* në shumën 20.000 euro, në datën 7.5.2007, në BKT dhe e tërhequr *cash* në datën 13.8.2007, disa ditë para blerjes së apartamentit. Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitojë dokumentacion justifikues mbi burimin e krijimit të kësaj shume, si dhe destinacionin.

Subjekti ka shpjeguar³¹se: *“Burimi i krijimit të shumës prej 20.000 euro, kanë qenë kursimet familjare, të krijuara pas vitit 2001 deri në momentin e blerjes të apartamentit nga babai më 16.8.2007. Në lidhje me ekzistencën e shumës prej 20.000 euro dhe krijimit të llogarisë bankare nuk kam pasur dijeni. Unë dhe prindërit kemi kontribuar nga ana financiare me të ardhurat që kam deklaruar në deklaratën Vetting për blerjen e apartamentit në datën 16.8.2007, si dhe në përgjigjet e pyetësorit të datës 2.7.2021. Babai ka qenë edhe menaxhues i të gjitha të ardhurave të familjes dhe shpenzimet e familjes ka qenë vetëm shpenzime jetike.*

Kjo shumë disponohej fizikisht nga babai dhe kjo ka qenë arsyeja përse kjo gjendje në vlerë monetare akumuluar, ndër vite, si dhe në momentin e depozitimit të saj në bankë nga babai nuk është deklaruar në deklaratat periodike si kursime. Pavarësisht se unë kam qenë i përfshirë në certifikatën e përbërjes familjare me prindërit e mi, babai, në cilësinë e disponuesit fizik të kësaj shume, si dhe të personit që ka çelur llogarinë bankare në datën 7.5.2007 dhe e ka mbyllur në datën 13.8.2007, nuk ka pasur detyrimin për t’i deklaruar faktet e mësipërme, si në cilësinë e subjektit deklarues ashtu edhe në cilësinë e personit të lidhur, në deklaratat periodike”.

Komisioni, ka analizuar mundësitë financiare të prindërve për kursim në shumën 20.000 euro, për periudhën 2001 – 2007, sipas tabelës në vijim:

Përshkrimi	Periudha 2001 – maj 2007
Të ardhura nga pensionet e prindërve (2001 – maj 2007)	1 428 060
Kursime <i>cash</i> në vlerën 20.000 euro	2 418 200
Shpenzime për dy persona (2001 – maj 2007)	1 280 220
Rezultati financiar	- 2 270 360

³¹Shpjegimet e subjektit, datë 5.7.2021, ndaj pyetësorit datë 1.7.2021.

Nga analiza e kryer, duket se prindërit e subjektit nuk kanë pasur mundësi për të kursyer me burime të ligjshme shumën 20.000 euro, duke rezultuar me balancë negative në shumën 2.270.360 lekë.

iv) Nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit, është evidentuar një tërheqje në shumën 1.650.000 lekë në datën 2.8.2007, të akumuluar, ndër vite, në llogarinë e pagës së subjektit në “Raiffeisen Bank”. Këtë shumë subjekti nuk e ka deklaruar as në DPV-të përkatëse dhe as në deklaratën *Vetting* si burim.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit mbi destinacionin e kësaj shume të tërhequr, i cili ka shpjeguar, ndër të tjera, se: “*Shuma e mësipërme është tërhequr për blerjen e apartamentit në datën 16.8.2007, si dhe për arredimin e banesës. Mobilimi është kryer në vitin 2007, në shumën prej rreth 230.000 (dyqind e tridhjetë mijë) lekë, për të përshtatur ambientet e dhomës së gjumit*”.

v) Komisioni kreu analizën financiare, për të vlerësuar burimet e ligjshme për krijimin e pasurisë, bazuar në të ardhurat e ligjshme të prindërve të subjektit dhe të ardhurat e subjektit të rivlerësimit.

Referuar fakteve se:

- a) subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* ndër vite;
- b) subjekti nuk ka qartësuar kontributin e tij në vlerën totale të blerjes së apartamentit;
- c) pasuria është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2007 dhe në deklaratën *Vetting*;
- d) subjekti e ka zotëruar këtë apartament me familjen ndër vite;
- e) subjekti ka qenë në certifikatë familjare me babanë dhe nënën gjatë viteve të deklarimit dhe blerjes së pasurisë, për pasojë, analiza financiare është kryer duke analizuar mundësitë e familjarëve dhe subjektit nga data 1 janar – 16 gusht 2007.

Në tabelën vijuese janë reflektuar shumat bazuar në dokumentacionin ligjor të administruar për të ardhurat, shpenzimet dhe likuiditetet bankare.

Përshkrimi	Periudha 1.1.2007 - 16.8.2007
Të ardhura	1 250 642
Të ardhura të subjektit nga paga	902 755
Të ardhura nga pensioni i babait	260 740
Të ardhura nga pensioni i nënës	70 220
Të ardhura nga interesat e depozitës në euro	16 927
Shpenzime	459 897
Shpenzime udhëtimi	61 422
Shpenzime jetese 7 muaj	398 475
Pasuri <i>neto</i>	1 834 192
Pasuri apartament	3 000 000
Diferencë likuiditeti	-1 165 808
Rezultati financiar	-1 043 447

Nga hetimi i kryer për këtë pasuri ka rezultuar se:

- a) Për depozitën bankare në emër të babait në shumën 20.000 euro, nga analizimi i të ardhurave të ligjshme prindërve, duket se ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 2.270.360 lekë.
- b) Nga analiza financiare e kryer për blerjen e apartamentit në datën 16.08.2007, duket se ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 1.043.447 lekë.

Komisioni i kaloi barrën e provës subjektivit në lidhje me konstatimet e mësipërme.

Qëndrimi i subjektivit të rivlerësimit

a) Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme të babait të subjektivit për krijimin e depozitës bankare prej 20.000 euro, subjekti ka prapësuar se në analizën financiare Komisioni ka marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e prindërve nga pensioni, të cilat janë pothuajse sa vlera e shpenzimeve jetike të përlllogaritura për këtë periudhë, ndërkohë që duhet të përfshihet edhe kontributi i tij në këtë periudhë nga të ardhurat e pagës në funksionin e prokurorit.

Subjekti ka shpjeguar se në periudhën 2001 – 2007, babai si kryefamiljar ka menaxhuar të gjithë ekonominë e familjes, ku në menaxhimin e të ardhurave familjare, pensionet e prindërve kurseheshin dhe me të ardhurat nga paga e subjektivit, përballoheshin të gjitha shpenzimet familjare.

Subjekti ka saktësuar se nga vitet 2001 deri në mars 2005 paga është marrë *cash* dhe pjesa më e madhe është depozituar në familje dhe vetëm një pjesë e vogël mbahej prej tij për përballimin e shpenzimeve personale.

Në vitin 2005 dhe në vazhdim subjekti ka dorëzuar një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave tek babai, por një pjesë e ka lënë edhe gjendje në llogarinë personale. Për këtë arsye, nuk ka deklaruar gjendje *cash* gjatë DPV-ve për vitet 2003 – 2006, pasi kjo gjendje nuk disponohej prej tij, por prej babait, e cila një pjesë ishte kursyer nga të ardhurat nga pensioni dhe pjesa tjetër nga të ardhurat në sektorin privat.

Sipas prapësimeve të subjektivit, prindërit nuk kanë pasur detyrimin për të deklaruar pasuritë e tyre, e cila ka sjellë edhe këtë konfuzion për kursimet *cash* ndër vite.

b) Sa i takon, të ardhurave të prindërve nga punësimi në sektorët privat, të cilat nuk janë konsideruar nga Komisioni në analizë financiare, subjekti ka referuar një sërë dispozitash ligjore³², në bazë të së cilave ka argumentuar se babai nuk mund të paguajë personalisht tatimin mbi të ardhurat dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pasi punëdhënësi ka detyrimin për deklarimin, evidentimin, mbajtjen dhe derdhjen e detyrimeve, si për tatimin mbi të ardhurat personale, ashtu edhe të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore. Në këto kushte, babai nuk mund të ketë përgjegjësi dhe të penalizohet për shkak se punëdhënësi nuk i ka paguar sigurimet shoqërore, madje në këtë aspekt është i dëmtuar.

Subjekti pretendon se babai ka përfituar të ardhurat nga paga, i janë bërë ndalesat përkatëse mbi pagën *bruto*, por agjenti i mbajtjes së tatimit, pavarësisht se e ka mbajtur tatimin, nuk e ka deklaruar dhe derdhur këtë tatim.

³²Nenet 109/1, 110, 117 dhe 121, të Kodit të Punës dhe neni 155 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (neni 13); ligji nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” (nenet 6 dhe 8); ligji nr. 7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (nenit 10/2 dhe 11); ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar (neni 8/a dhe neni 33); udhëzimi nr. 5, datë 30.1.2006, i ministrit të Financave, “Për tatimin mbi të ardhurat” (pikat 2.6.1 dhe 2.6.2); ligji nr. 9920, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (neni 5).

Subjekti ka kërkuar që në analizën financiare të përfshihen të ardhurat nga paga e tij si prokuror, por edhe të ardhurat e prindërve nga punësimi në sektorët privat deri në maj të vitit 2007, duke zbritur investimin në blerjen e automjetit dhe gjëndjes së likuiditetit në bankë dhe *cash*, nga e cila do të rezultonte një balancë pozitive në vlerën 6.751.401 lekë.

c) Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e apartamentit, për të cilën subjekti i është ngarkuar barra e provës, subjekti ka shpjeguar se ka kontribuar në familje me të ardhurat nga paga e tij, të cilën e ka dorëzuar në familje, duke hequr shpenzimet personale. Për rrjedhojë, gjendja *cash* nuk disponohet prej tij, por prej babait, i cili menaxhonte të ardhurat në familje. Problematika lidhur me mosdetyrimin e prindërve për të deklaruar pasurive të tyre ka sjellë konfuzion lidhur me kursimet *cash*, ndër vite. Subjekti nuk mund të përcaktojë ekzaktësisht sa ka qenë kontributi i tij në krijimin e kursimeve *cash* nga babai, por argumenton se kontributi për blerjen e apartamentit evidentohet me shumën 1.650.000 lekë të tërhequr nga llogaria e pagës në “Raiffeisen Bank”, pasi një nga burimet për blerjen e apartamentit kanë qenë edhe të ardhurat nga paga, pikërisht kursimet nga këto të ardhura që kanë krijuar gjendjen në llogari bankare.

Subjekti pretendon se në analizën financiare të kryer prej Komisionit, nuk duhet të përfshihet mundësia e subjektit dhe prindërve vetëm për periudhën kohore nga data 1 janar deri më 16 gusht 2007, por edhe më përpara në kohë, pasi rezulton e provuar se babai ka pasur kursime *cash*, të cilat janë depozituar në BKT dhe ky fakt duhet të vlerësohet nga Komisioni, duke mbajtur një qëndrim garantist ndaj tij.

Subjekti ka kërkuar që në analizën financiare të përfshihet gjendja *cash* e kursimeve të babait, së paku me vlerën e pensioneve të marra në periudhën 2001 – gusht 2007, si burim të ardhurash të ligjshëm dhe që prindërit kanë pasur mundësinë për të kursyer. Pasi, është fakt se tërheqja e kursimeve në datën 13.8.2007, tri ditë përpara blerjes së apartamentit, ka shërbyer si burim i drejtpërdrejtë në krijimin e kësaj pasurie, kur në të njëjtën kohë, gjatë hetimit administrativ nuk është evidentuar asnjë shpenzim tjetër i kryer që mund të ishte përballuar nga tërheqja e kësaj shume në BKT.

Nëse analiza financiare do të kryhej, për periudhën 2001 – gusht 2007, me përfshirjen e kursimeve *cash* të prindërve, të cilat minimalisht janë në shumën e të ardhurave, analiza financiare do të rezultonte me balancë pozitive në vlerën 133,437 lekë.

Vlerësimi i Komisionit

Në deklaratën *Vetting* pasuria apartament banimi me sip. 50m², me çmim blerje 3.000.000 lekë, është deklaruar në bashkëpronësi, ndërsa referuar akteve ligjorë (kontratë shitblerje dhe regjistrimi në ZVRPP) babai i subjektit është pronar i vetëm i kësaj pasurie.

Lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, nisur nga dokumentacioni i administruar dhe duke mbajtur në vëmendje edhe shpjegimet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës, për të evidentuar burime të ligjshme, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e familjes së subjektit, si dhe për të paguar blerjen e kësaj pasurie. Ky konkluzion bazohet në konstatimet dhe arsyetimet që vijojnë.

Subjekti nuk provoi burimin e ligjshëm të shumës prej 20.000 euro të depozituar *cash* në datën 7.5.2007, në BKT dhe e tërhequr po *cash* në datën 13.8.2007, për ta përdorur si burim për pagesën e kësaj pasurie. Pretendimi se ato ishin shuma të kursyera nga prindërit, nga të ardhurat nga pensioni dhe pjesa tjetër nga të ardhurat në sektorin privat, nuk u provua me dokumente ligjore dhe mbetet në nivel deklarativ.

Lidhur me shpjegimet dhe me pretendimin se nga viti 2005 dhe në vazhdim subjekti ka dorëzuar një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave tek babai, por një pjesë e ka lënë edhe gjendje në llogarinë personale dhe, për këtë arsye, nuk ka deklaruar gjendje *cash* gjatë DPV-ve, në periudhën 2003 – 2006, pasi kjo gjendje nuk disponohej prej tij, por prej babait, e cila një pjesë ishte kursyer nga të ardhurat nga pensioni dhe pjesa tjetër nga të ardhurat në sektorin privat, Komisioni vlerëson se nuk janë bindëse dhe mbeten në nivel deklarativ dhe të pa bazuara në dispozita ligjore dhe as në fakte të provuara. Mospasja e dijenisë, së pretenduar nga subjekti, mbi ekzistencën e shumës prej 20.000 euro, si dhe për kursimet *cash*, ndër vite, nuk e kalon pragun e besueshmërisë dhe të nivelit bindës, për shkak të kontributit, marrëdhënies familjare dhe të një analize logjike dhe duket si një tentativë për të shmangur përgjegjësinë dhe efektet që passjell mosdeklarimi i gjendjes *cash*, apo pamundësia financiare me burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë familjare.

Konkretisht, nuk mund të mohohet nga subjekti detyrimi i tij ligjor për të deklaruar kursimet *cash*, ndër vite, të familjes së tij, pasi kjo bie ndesh me këto fakte: (i) subjekti ka jetuar bashkë me prindërit e tij në të njëjtën banesë, duke kontribuar dhe përfituar si pjesë përbërëse e një ekonomie të përbashkët familjare; (ii) subjekti ka kontribuar edhe me të ardhurat e tij, në krijimin e kursimeve *cash*, sikurse është pohuar prej tij; (iii) pretendimi/shpjegimi se kursimet i menaxhonin, mbanin dhe akumulonin prindërit në padijeni të subjektit, duket jobindës dhe alogjik, për sa kohë bëhet fjalë për një familje me kontribut të ndërsjellë; (iv) ekzistonte detyrimi ligjor për deklarimin e përvitshëm të kursimeve *cash* të gjeneruara prej deklarimit të parë dhe në vijim, për sa kohë ato buronin nga ekonomia familjare e subjektit dhe e personave të lidhur me të, *de jure* dhe *de facto*.

Nisur nga këto rrethana dhe bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, lidhur me deklarimin e gjendjeve *cash*, ndër vite, Komisioni vlerëson se mungesa e deklarimit e këtyre vlerave monetare passjell pamundësinë për t'i përlllogaritur ato mes mjeteve monetare të disponuara nga familja e subjektit edhe nëse teorikisht analizat financiare të viteve përkatëse do të rezultonin me mundësi kursimi.

Lidhur me të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga puna e prindërve të subjektit në sektorin privat, vërehet se Komisioni i ka marrë në konsideratë dhe i ka përfshirë në analizë financiare të gjitha të ardhurat që kanë rezultuar me burim të ligjshëm, bazuar në dispozitat ligjore dhe në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, duke plotësuar kushtet e nevojshme akumulative të provës mbi ekzistencën e marrëdhënies së punës dhe evidentimit sasior të pagës së përfituar, si dhe të pagesës së detyrimeve tatimore lidhur me to. Pretendimet për të ardhura që mbeten në nivel deklarativ, duke mos plotësuar sa më lart, nuk janë burime të ligjshme dhe nuk mund të përfshihen në analizë financiare.

Gjithashtu, Komisioni ka pranuar kërkesën e subjektit për të përlllogaritur në analizën financiare familjare edhe të ardhurat për periudhën përpara vitit 2003, pasi edhe ato të ardhura kanë kontribuar në krijimin e kursimeve, për sa kohë nuk kishte detyrim për deklarimin e gjendjes *cash*.

Komisioni ka kryer analizën financiare në vijim, për të vlerësuar mundësinë e kursimit të shumës 20.000 euro nga babai i subjektit, në rast se merren në konsideratë:

- të ardhurat nga paga e subjektit në periudhën 2001 – 2002;
- të ardhurat e babait nga pensioni i pleqërisë;
- të ardhurat e nënës nga pensioni i pleqërisë.

Përshkrimi	Vlerat në lekë
Të ardhurat subjekti 2001 – 2002	699 303

Të ardhurat nga pensionet e prindërve 2001 – prill 2007	1 428 060
Të ardhura total	2 127 363
Shpenzime jetese për prinderit 2001 – prill 2007	1 280 220
Shpenzime jetese subjekti 2001 – 2002	187 728
Shpenzime total	1 467 948
Depozite hapur në datën 7.5.2007	2 418 200
Mundësia për të kursyer	- 1 758 785

Si konkluzion i analizave dhe vlerësimeve të lart përshkruara ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij kanë qenë në pamundësi financiare për të justifikuar plotësisht me burime të ligjshme, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, krijimin e shumës prej 20.000 euro, të depozituar *cash* në datën 7.5.2007, në BKT, si dhe për blerjen e apartamentit në fjalë, në datën 16.8.2007, në vlerën 3.000.000 lekë. Si rrjedhojë, subjekti dhe personat e lidhur me të kanë mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë apartament, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të germës “b”, të nenit 33/5, si dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

3. Automjet tip “Mercedes-Benz”, blerë nga subjekti në datën 25.7.2011, në Gjermani

Vlera e deklaruar: 12.000 euro + 1.000 euro shpenzime udhëtimi.

Zotërimi në përqindje: 100 %.

- Burimi i krijimit:
1. Të ardhurat e përfituara nga paga në funksionin e prokurorit.
 2. Të ardhurat nga babai nga pensioni i pleqërisë dhe suplementar, si dhe të ardhurat nga punësimi në sektor privat.
 3. Të ardhurat nga nëna nga pensioni i pleqërisë.
 4. Të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja nga punësimi në detyrën e specialistes pranë OJF-së “Sh.k.sh.k”, si dhe të ardhurat nga punësimi në sektor privat.
 5. Hua e marrë në datën 20.7.2011, në shumën 3,000 euro, marrëveshje verbale, pa interes me shtetasin F.M.
 6. Hua e marrë në datën 20.7.2011, në shumën prej 2,000 euro, marrëveshje verbale, pa interes me shtetasin A. Ll.

Në DPV-në e vitit 2011: nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- leje qarkullimi rrugor për automjetin me targa AA *** HA;
- faturë zhdoganimi, datë 12.7.2013;
- detyrime doganore në vlerën 342.673 lekë.

3.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

DPSHTRr-ja³³ ka konfirmuar automjetin e regjistruar në pronësinë e subjektit Ardian Braho.

³³Shkresë nr. *** prot., datë 7.10.2019, nga DPSHTRR-ja, për automjetin me targa AA *** HA.

3.2 Në lidhje me burimet e krijimit³⁴

- a) Subjekti ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie, të ardhurat e përfituara nga paga si prokuror, të ardhurat e prindërve, si dhe të ardhurat e bashkëshortes E. B, nga punësimi pranë OJF-së “Sh. K.Sh.K” dhe punësimi në sektor privat.

Komisioni ka kërkuar informacion pranë kësaj shoqate mbi marrëdhënien e punësimit të bashkëshortes pranë kësaj OJF-je dhe të ardhurat e përfituara prej saj. Në përgjigje të shkresës, organizata ka informuar³⁵ se znj. E.B ka punuar si eksperte trajnimesh në projektin “Forcimi i kapaciteteve institucionale i organizatave joqeveritare që veprojnë në fushën e shëndetit në Shqipëri”, në periudhën korrik - dhjetor 2008, por nuk ka dokumente financiare për të dokumentuar të ardhurat nga ky punësim meqenëse kanë kaluar mbi 10 vjet.

Nga hetimi i kryer ka rezultuar mungesë dokumentacioni mbi të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja pranë OJF-së, të deklaruara në shumën 3.000 USD.

- b) Lidhur me burimet e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti, subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe DPV³⁶ edhe dy hua të marra në vitin 2011, në shumën 2.000 euro, nga shtetasi A. Ll dhe shumën 3.000 euro marrë nga shtetasi F.M.

Komisioni i ka kërkuar³⁷ subjektit të japë shpjegime mbi marrëdhënien që ka me këta shtetas, si dhe të provojë me dokumentacion ligjshmërinë e burimit të krijimit të huave të dhëna nga këta shtetas.

Subjekti ka paraqitur dokumentacion provues për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave prej këtyre shtetasve, duke shpjeguar³⁸ se: “...ka shoqëri të ngushtë me këta dy shtetas që prej vitit 2006, e cila ka filluar si njohje nga shoqëri e përbashkët, pasi frekuentonin të njëjtin ambient. Në momentin e kërimit të huave, këta shtetas janë treguar të gatshëm për dhënien e huave”.

i. Në lidhje me huan e marrë nga shtetasi F.M, në shumën 3.000 euro

Subjekti ka shpjeguar se ky shtetas ka pasur gjendje fizike në vlera monetare, kursime të mbajtura në banesë, ku si burim ka referuar:

- shitjen e një apartamenti³⁹ në pronësi të këtij shtetasi në Tiranë, në vitin 2004, në shumën 1.950.000 lekë; si dhe

- dhënien me qira të një njësie shërbimi⁴⁰, në “Rr.K”, pranë “** Dh” Tiranë, te shoqëria “T” sh.a. me administrator shtetasin A.M, me qira 1.000 USD/muaj, nga vitit 2004 - 2015. Subjekti

³⁴Dokumentacion i administruar në dosje lidhur me këto burime janë: vërtetimi, datë 13.10.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i depozituar nga subjekti në ILDKPKI, ku konfirmohen të ardhurat e përfituara nga paga si prokuror në periudhën qershor 2008 – shtator 2016; vërtetim nr. *** prot., datë 30.4.2021 dhe vërtetim nr. ** prot., datë 30.4.2021, lëshuar nga ISSh-ja, mbi masën e pensionit të pleqërisë të prindërve të subjektit; nxjerrje llogarie e “Union Bank” dhe “lajmërimet kreditim page”, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI, në emër të znj. E. B, për kalimet e pagave nga punëdhënësi universiteti “K”, në periudhën shtator 2010 – korrik 2013.

³⁵Me shkresën nr. ** prot., datë 15.7.2021.

³⁶E vitit 2011.

³⁷Përmes pyetësorit me e-mail, datë 19.4.2021.

³⁸Në përgjigje të pyetësorit, datë 19.4.2021, mbërritur në datën 7.5.2021.

³⁹Dokumentacion i paraqitur nga subjekti me nr. *** prot., datë 7.5.2021: kontratë shitje me rezervë nr. ***, datë 20.7.2004, së bashku me certifikatë për vërtetim pronësie, datë 27.11.2003, për pasurinë apartament me sip. 82 m², kartelë pasurie dhe planimetri, të njehsuara me origjinalin nga noteri në datën 30.4.2021.

⁴⁰Subjekti ka paraqitur certifikatë pronësie, datë 5.1.2017, për pasurinë nr. **-N, njësi me sip.160 m², dhënë me qira nga shtetasi F.M, së bashku me kartelën e pasurisë dhe hartë treguese, dokumentacion i vërtetuar me origjinalin nga noteri në datën 4.5.2021.

ka paraqitur dy deklarata noteriale⁴¹ përmes së cilës shtetasi F.M dhe ish-administratori i shoqërisë “T” sh.a., z. A.M deklarojnë se marrëdhënia e qirasë nuk ka qenë e formalizuar me një kontratë të shkruar, pasi objekti i qirasë ishte një shtesë në katin e parë të një pallati në proces legalizimi që në vitin 2006.

Referuar dokumentacionit shtesë të përcjellë nga subjekti në shpjegimet e datës 6.7.2021⁴², rezulton se kjo marrëdhënie qiraje është formalizuar midis palëve me kontratën e qirasë nr. ***, datë 26.4.2007, për dhënie me qira të një ambienti me sip. 100 m², të ndodhur në rrugën “M. Gj”, Tiranë, për një periudhë 3-vjeçare, me qira mujore 1.100 euro/muaj. Pjesë e kësaj kontratë qiraje është edhe deklarata noteriale⁴³ e datës 25.6.2016 ku shoqëria qiramarrëse “T” sh.a. ka deklaruar se, pavarësisht përfundimit të afatit të qirasë më 26.4.2010, me miratim të heshtur kjo kontratë ka vazhduar deri në qershor të vitit 2016.

Referuar ekstraktit historik të shoqërisë “T” sh.a., pranë QKB-së, rezulton se në datën 7.7.2016, shoqëria ka mbyllur aktivitetin e saj në adresën dytësore tek “** Dhjetori”, Tiranë.

Nga verifikimi i kryer në sistemin e ASHK-së, mbi investime të mundshme të shtetasit F.M në pasuri të paluajtshme, ka rezultuar vetëm një pasuri në emër të tij, e cila është prona e dhënë me qira sa më sipër, me nr. pasurie ***-N, njësi me sip. 160 m².

✓ Në lidhje me shumën 3.000 euro, nga analizimi i dokumentacionit mbi burimet e ligjshme të huadhënësit, ka rezultuar se huadhënësi ka pasur mundësi financiare për dhënie e huas.

ii. Në lidhje me huan e marrë nga shtetasi A. Ll, në shumën 2.000 euro

Subjekti ka shpjeguar se ky shtetas ka pasur gjendje fizike në vlera monetare, kursime të mbajtura në banesë, duke referuar si burim aktivitetin tregtar që ky shtetas ka së bashku me të vëllanë dhe konkretisht shoqërinë “V-*” sh.p.k., të themeluar në vitin 2004 dhe shoqërinë “I D.C” sh.p.k. të themeluar në vitin 2008. Shuma e marrë hua është kthyer në vitin 2012⁴⁴.

Subjekti ka depozituar dokumentacion mbi të ardhurat dhe kontributet e derdhura nga punëdhënësit në shoqëritë “V-*” sh.p.k. dhe “I.D.C” sh.p.k. për shtetasit A.Ll dhe D.Ll, duke filluar nga viti 2004, si vijon:

- vërtetim për bazën e vlerësuar, lëshuar nga ISSh-ja Drejtoria Rajonale Durrës, mbi kontributet e derdhura nga punëdhënësi shoqëria “V *” sh.p.k., për periudhën 1.6.2004 – 2.5.2008, në shumën totale 692.904 lekë, për z. A. Ll;
- vërtetim për bazën e vlerësuar, lëshuar nga ISSh-ja Drejtoria Rajonale Durrës, mbi kontributet e derdhura nga punëdhënësi shoqëria “I.D.C” sh.p.k., për periudhën 20.4.2008 – 31.12.2011, në shumën totale 2.222.800 lekë, për z. A.Ll;
- vërtetim për bazën e vlerësuar nr. ***prot., datë 30.6.2021, i lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës, mbi kontributet e derdhura nga punëdhënësi shoqëria “I.D.C” sh.p.k., për periudhën 2012 – 2021, për z. A.Ll;
- vërtetim për bazën e vlerësuar i lëshuar nga ISSh-ja Drejtoria Rajonale Durrës, mbi kontributet e derdhura nga punëdhënësi shoqëria “V *” sh.p.k., për periudhën 1.8.2005 – 31.8.2007 (leje lindje 1.9.2007 – 2.12.2008), në shumën totale 559.011 lekë, për znj. D.G(Ll);

⁴¹Deklarata noteriale nr. ***, datë 4.5.2021, e shtetasit F.M; deklaratë noteriale nr. ***, datë 5.5.2021, e shtetasit A.M (ish-administrator i shoqërisë “T” sh.a., në vitet 2002 – 2015).

⁴²Në përgjigje të pyetësorit të datës 25.6.2021.

⁴³Deklaratë noteriale nr. ***, datë 25.6.2016, e nënshkruar nga administratori i shoqërisë “T” sh.a.

⁴⁴Subjekti ka depozituar dokumentacionin si më poshtë, protokolluar me nr. *** prot., datë 7.5.2021: deklaratë noteriale nr. ***, datë 4.5.2021, e shtetasit A.Ll; ekstrakt historik i regjistrit tregtar për subjektin “V-*” sh.p.k.; ekstrakt historik i regjistrit tregtar për subjektin “I. D.C” sh.p.k.

- vërtetim për bazën e vlerësua, lëshuar nga ISSh-ja Drejtoria Rajonale Durrës, mbi kontributet e derdhura nga punëdhënësi shoqëria “I.D.C” sh.p.k., për periudhën 12.12.2008 – 2.12.2010 (lejelindje janar – nëntor 2011), në shumën totale 995.700 lekë, për znj. D.G(Ll);
 - vërtetim për bazën e vlerësuar nr. ***prot., datë 30.6.2021, i lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës, mbi kontributet e derdhura në emër të znj. D. Ll, për periudhën 2012 – 2021.
- ✓ Në lidhje me shumën 2.000 euro, nga analizimi i dokumentacionit mbi burimet e ligjshme të huadhënësit, ka rezultuar se huadhënësi ka pasur mundësi financiare për dhënien e huas.

3.3 Komisioni ka hetuar mbi ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit, duke i kërkuar subjektit⁴⁵ të deklarojë dhe të depozitojë dokumentacion mbështetës, nëse ka pasur çështje penale të pushuara apo të mosfilluara, apo të dërguara për gjykim lidhur me personat huadhënës F.M dhe A.Ll.

Në përgjigje të pyetësorit të datës 21.5.2021, subjekti ka shpjeguar⁴⁶ se: *“Gjatë ushtrimit të funksionit të prokurorit, me shtetasit F.M dhe A.Ll, si në cilësinë e kallëzuesit apo të kallëzuarit, nuk kam pasur raste që kanë të bëjnë me mosfillimin e hetimeve, hetime të procedimeve penale, çështje penale të dërguara për gjykim apo në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale”,* si dhe ka depozituar dokumentacion mbështetës, të lëshuar nga prokuroritë ku ka ushtruar funksionin e prokurorit, si vijon:

- shkresë nr. *** prot., datë 3.6.2021, e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë;
- shkresë nr. ***-A prot., datë 2.6.2021, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- shkresë nr. *** prot., datë 2.6.2021, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Nga përmbajtja e dokumenteve me sipër, nuk ka rezultuar të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në emër të shtetasve huadhënës.

Nga verifikimi i akteve ka rezultuar se automjeti është blerë nga subjekti në vitin 2011, ndërsa zhdoganimi dhe regjistrimi i tij në emër të tij është kryer në vitin 2013. Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se detyrimet doganore për këtë automjet në shumën 340.000 lekë i ka paguar në vitin 2013. Gjithashtu, subjekti⁴⁷ ka shpjeguar se automjeti me targa AA ** HA është targuar më vonë, ku fillimisht mbante targën ***. Referuar ligjit të kohës (Kodit Doganor dhe Kodit Rrugor) afati për lejimin e përkohshëm të qarkullimit të mjeteve me targa të huaja përcaktohet nga autoritetet doganore për një periudhë maksimumi 24 muaj. Nga muaji shtator 2014 dhe ne vijim me udhëzim të Drejtorisë së Përgjithshme Doganore është përcaktuar afati 6-mujor për zhdoganimin e mjeteve.

- ✓ Nga hetimi ka rezultuar se shpjegimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e administruar nga DPSHTRr-ja.

3.4 Analiza financiare

Sipas dokumentacionit, automjeti rezulton i blerë në datën 25.7.2011.

⁴⁵Me e-mail, datë 21.5.2021.

⁴⁶Përmes e-mail-it, datë 28.5.2021.

⁴⁷Në përgjigje të pyetësorit, datë 26.4.2021, mbërritur në datën 29.4.2021.

Analiza financiare e kryer nga Komisioni për këtë pasuri është bazuar në dokumentacionin⁴⁸ zyrtar mbi të ardhurat e ligjshme të subjektit, bashkëshortes dhe prindërve, për periudhën janar – korrik 2011, për shkak se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*. Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur sipas shkresës përcjellë nga ILDKPKI-ja, për muajt respektivë sipas personave në certifikatën familjare. Në këtë analizë nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat nga punësimi në sektorë privat për prindërit.

Përshkrimi	Periudha 1.1.2011 - 25.7.2011
Pasuri	1 770 123
Automjet tip “Mercedes-Benz”	1 659 600
Diferencë likuiditeti	110 523
Detyrime	691 500
Hua marrë shtetasit F.M	414 900
Hua marrë shtetasit A.LI	276 600
Pasuri neto	1 078 623
Të ardhura	1 143 756
Të ardhura subjekti	676 429
Të ardhura bashkëshortja në universitetin “K”	211 438
Të ardhura nga pensionet e babait	188 756
Të ardhura nga pensioni i nënës	67 133
Shpenzime	536 775
Shpenzime jetese	398 475
Shpenzime udhëtimi	138 300
Rezultati financiar	- 471 642

Nga analizimi i burimeve të ligjshme, mbi të ardhurat e subjektit nga paga ,si dhe të ardhurat e familjarëve, ka rezultuar mungesë burimesh të ligjshme për të blerë automjetin në shumën 471.642 lekë.

Nga hetimi i kryer duket se:

- subjekti ka deklaruar saktë këtë pasuri në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-në e vitit 2011;
- subjekti ka provuar me dokumentacion ligjshmërinë e huamarrjeve, në vitin 2011;
- ka pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit.

Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, për mungesë burimesh të ligjshme, për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në shumën 471.642 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme, për të cilën subjekti i është ngarkuar barra e provës për të provuar të kundërtën, subjekti ka pretenduar se mungesa e deklarimeve periodike të prindërve ka sjellë edhe pasaktësi në analizat e kryera nga Komisioni, i cili ka marrë në konsideratë vetëm pensionin e prindërve në periudhën janar – korrik 2011 dhe jo

⁴⁸Shkresat nga ISSH-ja për pensionet e prindërve të subjektit dhe vërtetimi i pagës nga Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

kursimet *cash* që prindërit kanë pasur nga administrimi i ekonomisë familjare. Kursimet e babait kanë qenë si nga paga e subjektit, po ashtu edhe nga pensionet e tyre.

Subjekti ka shpjeguar se deri në vitin 2010 nuk ka deklaruar kursime *cash*, sepse ato nuk administroheshin prej tij, por prej babait dhe jo se nuk ka pasur kursime *cash* deri në fund të vitit 2010. Gjithashtu, nuk ka qenë i qartë në deklarimin e burimeve të krijimit sipas praktikës tashmë të konsoliduar, pasi ka menduar se kjo mënyrë deklarimi mund të krijonte pasaktësi dhe në DIPP-në e vitit 2011 ka deklaruar për herë të parë kursime *cash* në vlerën 300,000 lekë, ndërkohë babai vazhdonte të mbante dhe të dispononte kursimet *cash* të tij.

Sa më sipër, subjekti vlerëson se në analizën financiare duhet të përfshihen edhe kursimet *cash* që ka pasur babai deri në fund të vitit 2010, të cilat pavarësisht se për Komisionin nuk provohen sa kanë qenë kursimet *cash* të prindërve, mjafton të përfshihet pakësimi me në shumën 500.000 lekë i kursimeve *cash* të prindërve (të cilat vërtetohet se kanë pasur mundësi t'i kursejnë dhe në një vit vlera e pensionit të tyre ka qenë 500,000 lekë), ku analiza financiare do të rezultojë me mundësi financiare për blerjen e automjetit.

Vlerësimi i Komisionit

Lidhur me pretendimet e subjektit, për të marrë në konsideratë disponibilitetin dhe përdorimin e shumave të kursyera *cash* nga prindërit, ndër vite, sikurse është arsyetuar edhe në analizimin e burimeve të krijimit të pasurive të lartpërshkruara, Komisioni nuk mund t'i përfshijë ato në analizën financiare, për sa kohë që ato nuk janë deklaruar nga subjekti, si kursime të familjes së tij *de jure* dhe *de facto*, pavarësisht mundësive financiare të tyre për të kursyer. Ky është një qëndrim i konsoliduar tashmë edhe nga jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Për rrjedhojë, edhe pasi është njohur me rezultatet e hetimit, subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën mbi pamundësinë financiare, me burime të ligjshme, për blerjen e këtij automjeti.

Si rrjedhojë, subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë automjet, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të germës “b”, të nenit 33/5, si dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

4. Automjet tip “Volkswagen Polo”, blerë në datën 17.8.2012

Vlera e deklaruar: 4.000 euro.

Zotërimi në përqindje: 100 %.

Burimi i krijimit: të ardhurat nga puna si prokuror, të ardhurat e prindërve nga pensioni i pleqërisë dhe të bashkëshortes nga punësimi në sektorin privat dhe më pas në sektorin shtetëror, si dhe nga shitja e automjetit e tipit “Mercedes-Benz”, e llojit 190, të pasqyruar në kontratën e shitjes me nr. ***, datë 1.8.2012.

Në DPV-në e vitit 2012: subjekti ka deklaruar si burim, shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” dhe kursimet e realizuara gjatë viteve 2011 – 2012.

Mënyra e fitimit: me kontratë shitblerje automjeti nr. ***, datë 17.8.2012.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- lejë qarkullimi rrugor për automjetin me targa AA *** EO dhe faturë zhdoganimi, datë 18.8.2012;
- kontratë shitblerje, datë 17.8.2012, me palë shitëse z. D.T dhe palë blerëse z. Ardian Braho, për blerjen e një automjetit tip “Volkswagen”, viti i prodhimit 2002, në vlerën

4.000 euro. Në kontratën e shitjes është përcaktuar se palët janë likuiduar mes tyre për këtë shitblerje;

- kontratë shitje, datë 1.8.201, 2 me palë shitëse z. Ardian Braho dhe palë blerëse z. E. D, për shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa TR *** L, në vlerën 2.500 euro.

4.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

DPSHTRr-ja⁴⁹ ka konfirmuar automjetin e regjistruar në pronësinë e subjektit, me targa AA *** EO. Referuar dosjes së automjetit evidentohet se automjeti është blerë nga subjekti me kontratën e shitblerjes, datë 17.8.2012, në vlerën 4.000 euro.

ISSh-ja⁵⁰ ka dërguar informacion mbi kontributet e derdhura nga viti 2012 dhe vijues, për subjektin e rivlerësimit Ardian Braho, bashkëshorten, si dhe masën e pensioneve të përfituara nga prindërit.

Për sa i përket burimit të ligjshëm që ka shërbyer për blerjen e këtij automjeti, subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, se një pjesë e të ardhurave është siguruar nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në datën 1.8.2012, në vlerën 2.500 euro. Ky automjet është blerë nga subjekti i rivlerësimit Ardian Braho në vitin 2004, në vlerën 250.000 lekë.⁵¹

Lidhur me këtë burim, subjekti ka depozituar aktin e shitjes⁵² së automjetit tip “Mercedes - Benz”, viti i prodhimit 1989, në datën 1.8.2012.

4.2 Analiza financiare për këtë pasuri

Nga verifikimi i deklarimeve në DPV, si dhe dokumentacionit në dosje, ka rezultuar se subjekti ka pasur kursime *cash* të deklaruara në vitin 2011, në shumën 300.000 lekë (ose e konvertuar 2.150 euro). Gjithashtu, rreth dy javë përpara blerjes së automjetit, ka rezultuar se subjekti ka shitur një automjet tjetër në shumën 2.500 euro. Këto dy shuma kanë mundur të mbulojnë shpenzimin për blerjen e automjetit.

Nga hetimi i kryer duket se:

- a) subjekti ka deklaruar saktë burimin financiar të blerjes së këtij automjeti në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-në e vitit 2012;
- b) subjekti ka pasur mundësi financiare për të blerë automjetin me burime te ligjshme.

Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

5. Llogari bankare në BKT, në emër të babait të subjektit, e çelur në datën 30.7.2014

Vlera e deklaruar:	12.980 euro.
Zotërimi:	mbajtës i vetëm i depozitës z. E.B (babai).
Burimi i krijimit:	të ardhurat nga puna si prokuror, të ardhurat e prindërve nga pensioni i pleqërisë, si dhe të bashkëshortes nga punësimi në sektorin privat dhe më pas në sektorin shtetëror.

⁴⁹Shkresë nr. *** prot., datë 7.10.2019.

⁵⁰Shkresë nr. *** prot., datë 3.10.2019.

⁵¹Sipas deklaramit të subjektit në DPV-në e vitit 2004.

⁵²Kontratë shitjeje nr.***, datë 1.8.2012.

Në DPV-në e vitit 2014: subjekti ka deklaruar, llogari bankare në BKT, në emër të babait E.B, burimi i krijimit janë kursimet nga viti 2011 deri në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrjen e llogarisë nga BKT-ja në datën 4.1.2017, në emër të shtetasit E.B, në euro, për depozitën në shumën 12.980 euro, derdhur në llogari në datën 30.7.2014.

5.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

BKT-ja⁵³ ka konfirmuar depozitën bankare në emër të babait të subjektit E.B, në vlerën 12.980 euro, me afat 1-mujor, automatikisht e rinovueshme, ndërsa subjekti dhe personat e tjerë nuk rezultojnë të kenë pasur llogari pranë kësaj banke. Bashkëlidhur ndodhen pasqyrat e llogarisë së depozitës së babait të subjektit E.B dhe llogaritë e tij rrjedhëse (aktualisht të mbyllura) monedhat dollar, lekë dhe euro.

Nga analizimi dhe verifikimi i dokumentacionit të përcjellë nga banka, evidentohet se mbajtës i llogarisë së depozitës bankare është vetëm babai i subjektit E.B.

5.2 Analiza financiare për depozitën në emër të babait në shumën 12.980 euro

Nisur nga deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting*, ku deklaron si burim për këtë llogari të ardhurat nga puna si prokuror, të ardhurat e prindërve nga pensioni i pleqërisë, si dhe të bashkëshortes nga punësimi në sektorin privat dhe më pas në sektorin shtetëror, Komisioni ka analizuar të ardhurat e ligjshme familjare të tyre, si dhe mundësitë financiare për krijimin e depozitës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se subjekti ka deklaruar kursime *cash* për herë të parë në vitin 2011. Nga analizimi i deklarimeve periodike vjetore, subjekti ka deklaruar kursime *cash*, ndër vite, për periudhën 2011 – 2014, siç paraqitet në tabelën vijuese:

Përshkrimi	2011	2012	2013	2014
Kursime cash	300 000	1 200 000	1 800 000	450 000
Përshkrimi në DPV	Kursime nga 1 janar - 31 mars 2012, në shumën 300.000 lekë	Shtim i pasurisë me 900.000 lekë, nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes, si dhe pensionet e prindërve nga 1.3.2012 - 1.03.2013	Shtim i pasurisë nga kursime të realizuara nga pagat e subjektit, të bashkëshortes dhe pensionet e prindërve në shumën 600.000 lekë. Kursimet janë <i>cash</i> jashtë sistemit bankar	Kursime nga pagat dhe pensionet për gjysmën e dytë të vitit 2014

⁵³Me shkresën nr. *** prot., datë 9.10.2019.

Likuiditete në bankë				1 819 608
Përshkrimi në DPV				Llogari bankare në BKT, në emër të babait E.B. Burimi i krijimit janë kursimet nga 2011 -gjashtëmuji i parë i vitit 2014

Komisioni analizoi mundësitë financiare për krijimin e kësaj depozite në BKT dhe nisur nga fakti që subjekti paraqitet në një certifikatë familjare së bashku me prindërit e tij, u verifikuan, gjithashtu, edhe deklaratimet e subjektit në DPV-të periodike, për sa i përket deklaratimit të kursimeve *cash*, si dhe llogarive bankare të subjektit, sipas tabelës vijuese:

Pershkrimi	2011	2012	2013	2014
Pasuri	1 915 499	1 469 172	587 458	469 468
Autoveture Benz	1 659 600			
Automjet Wolksvagen		558 880		
Diference likuiditeti	255 899	910 292	587 458	469 468
Likuiditete ne fund te vitit	302 390	1 212 682	1 800 140	2 269 608
Gjendje cash	300 000	1 200 000	1 800 000	450 000
Likuiditete ne banke	2 390	12 682	140	1 819 608
Detyrime	691 500	- 416 320	- 280 420	-
Hua shtetasit F M	414 900	-139 720	-280 420	
Hua shtetasit A Ll	276 600	-276 600		
Pasuri neto	1 223 999	1 885 492	867 878	469 468
Te ardhura	2 273 494	2 485 484	2 212 421	2 540 993
Te ardhura Subjekti	1 190 415	1 201 667	1 247 106	1 455 864
Te ardhura b/shortja	607 548	540 406	452 525	559 854
Te ardhura nga pensionet e babait	334 243	347 387	360 362	370 978
Te ardhura nga pensioni i nenes	141 288	146 024	152 428	154 297
Te ardhura ngashitja e automjetit benz		250 000		
Shpenzime	826 475	986 394	1 535 317	1 664 988
Shpenzime jetese	683 100	846 144	846 144	1 319 988
Shpenzime udhetimi	143 375			
Shpenzime shkollimi vajza		140 250	346 500	345 000
Shpenzime mobilimi				
Pagese zhdoganimi ne RZB			342 673	
Rezultati financiar	223 020	-386 402	-190 774	406 537

Referuar analizës financiare të përgjithshme, për periudhën 2011 – 2014, duket se subjekti nuk ka pasur mundësi për të krijuar kursimet *cash* me burime të ligjshme për vitet 2012 dhe 2013, në shumën totale prej **577.176** lekësh dhe, për rrjedhojë, duket se ka pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për krijimin e depozitës me shumë 12.980 euro.

Komisioni, në lidhje me këtë rezultat hetimi, i kaloi barrën e provës subjektit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për të cilën është ngarkuar barra e provës, subjekti ka prapësuar se në analizën financiare të kryer prej Komisionit duhet të korrektohen shpenzimet jetike të fëmijëve, në vitet 2012 dhe 2013, pasi djali i tij ka lindur në datën 25.10.2011 dhe Komisioni nuk i ka përfshirë shpenzimet jetike për vitin 2011, por i ka përfshirë ato për vitin 2012.

Analiza financiare duhet të ndryshohet për vitin 2012, në lidhje me shpenzimet jetike të djalit, ku deri sa djali ka mbushur moshën 1 vjeç shpenzimet jetike kanë qenë të vogla. Nëse për vitin 2012 shpenzimet jetike korrigjohen në shumën 117.520 lekë më pak, që i përket shpenzimeve jetike për një person për 10 muaj, atëherë balanca negative do të ishte në vlerën 268,882 lekë.

Gjithashtu, subjekti pretendon se për vitin 2013 shpenzimet jetike duhet të korrigjohen në ulje, pasi vajza ka të përfshirë në pagesën e shkollës mëngjesin, drekën dhe zemrën e pasdites dhe shpenzimet jetike për vajzën nuk mund të jenë ato për një person, në kushtet, kur pjesën më të madhe të kohës e kalon në shkollë. Nëse në analizën financiare për vitin 2013 shpenzimet jetike për vajzën do t'i përlllogarisnim sa 1/3 e shpenzimeve jetike për person (pasi dy vakte i kalon në shkollë) , atëherë do të kishim një korrigjim në ulje të shpenzimeve jetike për këtë vit në shumën 94,016 lekë, pra, rezultati për vitin 2013, do të ishte me pamundësi në shumën 96,758 lekë.

Subjekti argumenton se organet e rivlerësimit për llogaritjen e zërit “shpenzime jetese”, i referohen shkresës së datës 4.3.2019, së ILKDPKI-së, e cila në vetvete i referohet analizave statistikore të INSTAT-it, për buxhetin e familjes dhe në tabelat statistikore për zërin “shpenzime jetese” përfshihen: *“Ushqim dhe pije jo-alkoolike, pije alkoolike, duhan, veshje dhe këpucë, shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike, qira të paguar, mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të zakonshme të banesës, shëndet, transport, komunikim, argëtim dhe kulture, arsim, restorante dhe hotele, të tjera mallra dhe shërbime”*. Në kuadër të këtij arsytimi, subjekti argumenton se një pjesë e shpenzimeve të kryera prej tij, për pagesën e shkollës janë të përfshira në shpenzimet jetike sipas INSTAT-it.

Sipas subjektit, nëse në analizën financiare për këtë pasuri përfshihen edhe kursimet *cash* të akumuluar në vitin 2010-2011 nga prindërit e tij, diferenca do të rezultonte pozitive.

Vlerësimi i Komisionit

Lidhur me pretendimet e subjektit, për sa i përket burimeve të krijimit të kësaj depozite, Komisioni, nisur nga standardet e krijuara për aplikimin e të dhënave minimale të kostos së jetesës, sipas INSTAT-it - pavarësisht moshës së anëtarëve të familjes dhe/ose frekuentimit të shkollave apo kopshteve. Shpenzimet e jetesës nuk mund të zbriten nga analiza financiare, pasi shpenzimet e arsimit privat nuk mund të argumentohen se janë pjesë e shpenzimeve bazike të jetesës. Në kushtet kur ky shërbim në Republikën e Shqipërisë ofrohet me shpenzime modeste nga institucionet publike, i njëjti shërbim i ofruar nga biznese private është përtej nivelit bazik të jetesës së marrë për bazë në përlllogaritjet e institucioneve të rivlerësimit sipas informacionit të përcjellë nga INSTAT-it. Shpenzimet bazike që përlllogariten sipas INSTAT-it, janë mbështetur mbi një mesatare të përgjithshme që përfshin edhe nivelin e varfërisë, bazuar në shpenzimet e përditshme jetike të qëndrimit dhe jetesës në Republikën e Shqipërisë dhe pagat mujore të këtushme. Ato referohen në mungesë të dokumentacionit si dyshemeja nën të cilën nuk mund të argumentohet, përveçse mbi prova shkresore. Gjithashtu, edhe nga sa është arsyetuar më sipër mbi pamundësinë e konsiderimit dhe përfshirjes në analizë financiare të kursimeve hipotetike *cash* të familjes së subjektit të pa deklaruara ndonjëherë, nuk evidenton elemente që mund të ndryshojnë rezultatin e arritur në fund të hetimit administrativ, sikurse i është njoftuar subjektit. Për këto arsye, këto pretendime të subjektit u gjetën të pabazuara.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se babai i subjektit ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e depozitës, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të germës “b”, të nenit 33/5, si dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

6. Gjendje *cash*, në banesë

Vlera e deklaruar: 1.300.000 lekë.

Zotërimi: bashkëpronësi sipas certifikatës familjare.

Burimi i krijimit: nuk ka deklaruar burimin financiar të krijimit të kësaj vlere monetare.

Nga verifikimi ka rezultuar se:

a) Referuar deklarimeve periodike vjetore⁵⁴, subjekti ka deklaruar kursime *cash*, për vitet 2014 dhe 2015, me burim të ardhurat familjare të deklaruar ndër vite.

Përshkrimi	2014	2015	2016
Kursimet <i>cash</i>	450 000	1 300 000	1 300 000
Të deklaruara në DPV	Kursime nga pagat dhe pensionet për gjysmën e dytë të vitit 2014	Gjendje fizike e lekëve në disponim të pa depozituara në sistemin bankar	-

Referuar pikës 5 të këtij raporti, janë analizuar kursimet e deklaruara nga viti 2011 – 2013, të cilat u depozituan në BKT, në emër të babait. Si rrjedhim, Komisioni analizoi deklaratimet e gjendjeve *cash*, si dhe mundësinë e krijimit të tyre me burime të ligjshme nga viti 2014 dhe në vijim, sipas tabelës vijuese:

Përshkrimi	2014	2015	2016
Pasuri	469 468	817 793	- 21 760
Diferencë likuiditeti	469 468	817 793	- 21 760
Likuiditete në fund të vitit	2 269 608	3 087 401	3 065 641
Gjendje <i>cash</i>	450 000	1 300 000	1 300 000
Likuiditete në bankë	1 819 608	1 787 401	1 765 641
Detyrime	-	-	-
Pasuri <i>neto</i>	469 468	817 793	- 21 760
Të ardhura	2 540 993	2 554 819	2 576 926
Të ardhura subjekti	1 455 864	1 450 170	1 182 861
Të ardhura bashkëshortja	559 854	570 422	600 859
Të ardhura nga pensioni i babait	370 978	377 361	382 890
Të ardhura nga pensioni i nënës	154 297	156 866	158 588
Të ardhura nga interesat e depozitës			251 728
Shpenzime	1 664 988	2 061 421	2 127 781
Shpenzime jetese	1 319 988	1 345 656	1 410 552
Shpenzime udhëtimi		363 765	13 527
Shpenzime shkollimi vajza	345 000	352 000	352 000
Shpenzim për filtrin e ujit deklaruar nga subjekti			351 702
Rezultati financiar	406 537	-324 395	470 905

⁵⁴Kursime të padeponuara në sistemin bankar, të deklaruara nga subjekti në: në DPV/2012, deklaruar kursime në shumën 900.000 lekë; në DPV/2013, deklaruar kursime në shumën 600.000 lekë; në DPV/2014, deklaruar kursime në shumën 450.000 lekë; në DPV/2015, deklaruar kursime gjendje *cash* në shumën 1.300.000 lekë; në DPV/2017, deklaruar pakësim të kurisimeve *cash*, në shumën 150.000 lekë.

Sa më sipër, për këtë pasuri ka rezultuar pamjaftueshmëri likuiditetesh, në shumën 324.395 lekë, për kursimet *cash*, duke i kaluar barrën e provës subjektit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Sa i takon pamjaftueshmërisë së likuiditeteve në vitin 2015, subjekti ka prapësuar se në këtë vit duhet të korrigjohen në ulje shpenzimet jetike për vajzën, pasi pagesa e shkollës përfshin në çmim edhe vaktet ushqimore, të cilat konsumohen në shkollë dhe në analizën financiare do të thotë ngarkim i shpenzimeve jetike dy herë, në masën takuese që shpenzimet e tarifës së shkollimit përfshijnë edhe ushqimin.

Lidhur me diferencat negative të konstatuara nga Komisioni, për gjendjen në llogarinë bankare të babait në BKT, në shumën 12.980 euro, si dhe gjendjen *cash* në shumën 1.300.000 lekë, subjekti ka kërkuar të vlerësohen nga Komisioni, në dritën e parimit të proporcionalitetit.

Sipas subjektit, diferencat e konstatuara nga Komisioni mbulohen nga kursimet *cash* të prindërve, të cilat përdoren herë pas herë për nevojat familjare, por pavarësisht këtij fakti këto diferenca bazuar në parimin e proporcionalitetit janë të tilla që nuk mund të konkludohet për pamjaftueshmëri.

Vlerësimi i Komisionit

Sikurse është arsyetuar edhe në pikën 5.2 të këtij vendimit, lidhur me pakësimin e shpenzimeve jetike, Komisioni vlerëson se, për të njëjtat arsye, pretendimet e subjektit nuk mund të pranohen. Megjithatë, thjesht për të qartësuar situatën konkrete, vërehet se në çdo rast edhe sikur të pranoheshin këto pretendime, nga rishikimi i analizës financiare do të kishim një pakësim minimal të shpenzimeve jetike, nga ku ndryshimi/zvogëlimi i pamundësisë financiare nuk do të kishte peshë ndikuese mbi rezultatin final dhe mbi vendimmarrjen.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash*, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të germës “b”, të nenit 33/5, si dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

7. Llogari page në vlerën 82 lekë, në “Credins Bank”

7.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

“Credins Bank”⁵⁵ ka konfirmuar llogarinë e pagës në emër të z. Ardian Braho nga momenti i çeljes së llogarisë deri në datën 30.11.2019. Bashkëlidhur shkresës ndodhet pasqyra e llogarisë së pagës.

Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit, i cili ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

8. Llogari page e bashkëshortes në vlerën 252 lekë, në “Credins Bank”

8.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

“Credins Bank”⁵⁶ ka konfirmuar llogarinë e pagës në emër të bashkëshortes së subjektit, znj. E.B, nga momenti i çeljes së llogarisë deri në datën 30.11.2019. Bashkëlidhur shkresës ndodhet pasqyra e llogarisë së pagës.

⁵⁵Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2019.

⁵⁶Shkresë e ardhur me nr. *** prot., datë 18.12.2019.

Nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë nga banka, zotërues i llogarisë bankare është vetëm bashkëshortja e subjektit E.B.

Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit, i cili ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

9. Gjetje të tjera të rezultuara nga hetimi i Komisionit

9.1 Pasuri të trashëguara nga prindërit e subjektit

Nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë nga ASHK-ja Devoll⁵⁷ ka rezultuar se prindërit e subjektit kanë përfituar përmes trashëgimisë ligjore pasuri të paluajtshme si vijon:

i. Pemëtores me sip. 740 m², në B, Devoll, e fituar nga babai i subjektit, z. E.B, që ka trashëguar 1/7 pjesë të pasurisë trashëgimore.

ii. Arë me sip. 4.800 m², në B, Devoll, e fituar nga nëna e subjektit, znj. S.B, që ka trashëguar 1/36 pjesë të pasurisë trashëgimore.

Mbi këto pasuri të padeklaruara në deklaratën *Vetting*, Komisioni i ka kërkuar⁵⁸ subjektit të japë shpjegime dhe, në përgjigje, subjekti ka shpjeguar⁵⁹ se nuk ka qenë në dijeni të ekzistencës së këtyre pasurive në emër të prindërve dhe të drejtave të tyre pronësore, pasi që prej vitit 1970 prindërit janë shpërngulur për të jetuar dhe banuar në qytetin e Shkodrës deri në vitin 2001 dhe që prej këtij viti dhe aktualisht jetojnë dhe banojnë në qytetin e Tiranës. Në vijim, subjekti ka saktësuar se këto prona janë përfituar, ndër disa parcela, nga gjyshërit e subjektit në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën" dhe aktualisht janë në posedim nga të afërmit e subjektit (xhaxhai dhe daja). Pasi gjyshërit kanë ndërruar jetë, prindërit në asnjë moment nuk kanë shfaqur interes në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe paluajtshme në pronësi të prindërve dhe nuk kanë kërkuar ndonjëherë çelje të trashëgimisë ligjore dhe më pas të kenë aplikuar për regjistrimin e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme në emër të tyre. Prindërit e subjektit nuk janë njoftuar për veprimet e mësipërme juridike të realizuara nga të afërmit (xhaxhai dhe daja) apo nga institucione në lidhje me pasurinë e sipërcituar.

Subjekti citon se: *"Në interpretim të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me deklaramin periodik të pasurive, si dhe deklaramin e personave të lidhur për shkak të konfliktit të interesit, gjykoj se nuk kam pasur detyrimin për deklaramin e pasurive të prindërve të mi, këta të fundit, në cilësinë e subjektit deklarues apo si persona të lidhur. Në lidhje me pasuritë e sipërcituara dhe të kërkuara nuk kam pasur asnjë informacion dhe dijeni në lidhje me ekzistencën e tyre dhe të drejtat pronësore që kanë prindërit e mi, kjo për faktin se personalisht nuk kam qenë drejtpërdrejt përfitues i këtyre të drejtave nga prindërit e mi, nuk kam qenë ndonjëherë posedues dhe as përfitues i të mirave nga këto pasuri. Pasuritë e sipërcituara kanë një burim të ligjshëm për përftimin e tyre nga prindërit e mi, ku nisur edhe nga sipërfaqja e vogël dhe vendndodhja e tyre, mendoj se duhet të merret në konsideratë dhe të çmohet nga ana juaj se,*

⁵⁷Dokumentacioni i administruar nga ASHK-ja Devoll me shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2019, si vijon:

- AMTP nr. ***, në emër të z. F.M; vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr.***, datë 13.5.2016 për trashëgimlënësen, znj. S.M; aplikim nr.***, datë 26.5.2016, pranë ZVRPP-së Devoll për regjistrimin e aktit të trashëgimisë; mandatpagesë datë 26.5.2016, lëshuar nga BKT-ja;

- ATMP nr. *** akti, në emër të z. N.B; dëshmi e trashëgimisë ligjore nr.***, datë 23.5.2016, për trashëgimlënësit N dhe R B; aplikim nr. **, datë 23.5.2016, pranë ZVRPP-së Devoll për regjistrimin e aktit të trashëgimisë; mandat bankar datë 23.6.2016, të lëshuar nga BKT-ja; deklaratë noteriale nr. ***, datë 23.5.2016, për caktimin e përfaqësuesit të ri të familjes bujqësore; prokurë e posaçme nr. ***, datë 23.5.2016; vërtetim datë 24.5.2016, i Bashkisë Devoll; certifikatë familjare datë 20.5.2016; vërtetim datë 13.5.2016 i OSHEE-së; kartelë e pasurisë së paluajtshme për pasurinë nr. **, pemëtores me sip. 740 m².

⁵⁸E-mail datë 27.5.2021.

⁵⁹Përmes email-it datë 28.5.2021.

përveç faktit të mosdijenisë nga unë dhe prindërit e mi nuk ka pasur ndonjë shkak tjetër për mosdeklarimin e tyre (nëna si trashëgimtare me 1/36 pjesë)”.

Për sa ka shpjeguar më sipër, subjekti ka depozituar dokumentacionin mbështetës⁶⁰.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja Devoll, ka rezultuar se këto pasuri janë fituar nga gjyshërit e subjektit me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, të cilat janë trashëguar më pas nga prindërit e subjektit E dhe S. B.

Në lidhje me mosdeklarimin e pasurive të mësipërme në deklaratën *Vetting*, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit.

Qëndrimi i subjektit

Në lidhje me konstatimin e Komisionit, subjekti, në prapësimet e depozituara në datën 19.10.2021, ka shpjeguar, ndër të tjera, se nuk ka pasur asnjë informacion dhe dijeni në lidhje me ekzistencën e këtyre pasurive të trashëguara nga prindërit dhe të drejtat pronësore të tyre, kjo për faktin se nuk ka qenë drejtpërdrejt përfitues i këtyre të drejtave, nuk ka qenë posedues dhe as përfitues i të mirave nga këto pasuri. Subjekti ka shpjeguar se prindërit e tij në asnjë moment nuk kanë shfaqur interes në lidhje me këto pasuri dhe nuk kanë kërkuar ndonjëherë çelje trashëgimie.

Lidhur me pasurinë e trashëguar nga prindërit, subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se çelja e trashëgimisë dhe më pas regjistrimi i pasurisë është kryer nga xhaxhai dhe daja i tij, me qëllim përfitimin në pronësi të tyre të sipërfaqeve trashëgimore, të cilat janë poseduar prej tyre në mënyrë të vazhdueshme, që prej asaj kohe dhe aktualisht.

Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se babai i tij, në datën 23.5.2016, ka nënshkruar një prokurë të posaçme duke emëruar si përfaqësuese ligjore nusen e xhaxhait, shtetasen R.B, për të kryer veprime në lidhje me pronat që babai do të përfitonte si trashëgimtar ligjor, pa përcaktuar pronë konkrete. Në vijim, në datën 30.5.2017, nusja e xhaxhait, në cilësinë e përfaqësueses ligjore të të gjithë trashëgimtarëve, ndër ta edhe e babait, ka hequr dorë nga pronësia me qëllim regjistrimin e pasurisë në favor të xhaxhait B.B, kalim i cili nuk është regjistruar për arsye personale të xhaxhait.

Lidhur me pasurinë e trashëguar nga nëna, subjekti ka shpjeguar se daja i tij, në datën 13.5.2016, ka kërkuar “lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë” për gjyshërit e ndjerë dhe më pas ka realizuar regjistrimin e pasurisë dhe nëna nuk është njoftuar për kryerjen e këtyre veprimeve juridike, e cila me vullnetin e saj ka kaluar çdo të drejtë në emrin e të vëllait dhe në datën 23.6.2021 ka nënshkruar kontratën e dhurimit të pjesës së saj takuese.

Subjekti ka shpjeguar se prindërit nuk kanë pasur informacion dhe dijeni në lidhje me këto pasuri dhe të drejta pronësore dhe, për shkak të disa rrethanave dhe, me konkretisht, të faktit që: (i) prindërit kanë jetuar gjithnjë larg vendit ku kanë lindur dhe ku ndodhen këto pasuri; (ii)

⁶⁰Dokumentacion i paraqitur nga subjekti, protokolluar me nr. *** prot., datë 7.6.2021 dhe nr. *** prot., datë 2.7.2021 si vijon: për pasurinë e trashëguar nga z. E. B (babai i subjektit): dëshmi trashëgimie ligjore nr. ***, datë 23.5.2016; prokurë e posaçme nr. ***, datë 23.5.2016; deklaratë noteriale nr. ***, datë 23.5.2016, për caktimin e përfaqësuesit të ri të familjes bujqësore; deklaratë nr. ***, datë 30.5.2017, për heqje dorë nga pronësia e pasurive të fituara me trashëgimi; kartelë e pasurisë së paluajtshme nr. *** (pemëtoare me sip. 740 m²) e gjeneruar elektronikisht nga ASHK-ja Devoll më 7.6.2021; AMTP në emër të z. N. B; vërtetim datë 24.5.2016 i Bashkisë Devoll; certifikatë familjare të datave 20.5.2016 dhe 24.5.2016. Për pasurinë e trashëguar nga znj. S. B (nëna e subjektit): kartelë e pasurisë të paluajtshme nr. *** e gjeneruar elektronikisht nga ASHK-ja Devoll, më 7.6.2021; AMTP me nr. akti ** në emër të z. F.M; deklaratë noteriale nr. ***, datë 26.5.2016, për caktimin e përfaqësuesit të ri të familjes bujqësore; deklaratë noteriale nr. ***, datë 20.5.2016, e nënshkruar nga znj. S. B; vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 13.5.2016; vendim për lëshimin e trashëgimisë testamentare nr. ***, datë 13.5.2016; vërtetim datë 19.5.2016 i Bashkisë Devoll; certifikatë familjare datë 19.5.2016; AMTP nr. akti *** në emër të z. F.M.

pasuritë janë rrjedhojë e përfitimit nga një proces gjithëpërfshirës i shpërndarjes së tokës në të gjithë territorin dhe nuk kanë të bëjnë me pasuri, që të jenë trashëgimi brez pas brezi, për të cilat prezumohet dijenia; (iii) tradita familjare e përfitimit të pasurive nga fëmija që kujdeset për prindërit, si dhe për faktin që asnjëherë dhe në asnjë rrethanë nuk kanë poseduar dhe nuk kanë përfitur të mira nga këto pasuri.

Këto pasuri kanë një burim të ligjshëm për përfitimin e tyre nga prindërit nëpërmjet trashëgimisë ligjore ku nisur edhe nga sipërfaqja e vogël dhe vendndodhja e tyre, subjekti argumenton se përveç faktit të mosdijenisë nuk ka pasur ndonjë shkak tjetër për mosdeklarimin e tyre.

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni ka analizuar aktet e administruara gjatë hetimit, ku është evidentuar se nëna e subjektit, përmes një deklarate noteriale⁶¹ datë 20.5.2016, i ka kaluar vëllait të saj, z. B.M(daja i subjektit), tagra administrimi, posedimi dhe dhënie me qira, për pronat që i vijnë me trashëgimi nga nëna e saj. Po ashtu, provohet me dokumentacion se babai i subjektit, përmes prokurës së posaçme⁶² datë 23.5.2016, i ka kaluar tagra përfaqësimi shtetasve B (xhaxhai i subjektit) dhe R.B, për çdolloj veprimi juridik që do të lind në të ardhmen për pasurinë që disponojnë të përfitur nga çdolloj titull pronësie, trashëguar apo anëtar me ligjin nr. 7501, me vendndodhje në B, Devoll.

Nisur nga shpjegimet e subjektit, si dhe nga dokumentacioni i administruar në dosje, ka rezultuar se këto pasuri në bashkëpronësi të prindërve të subjektit duhej të ishin deklaruar dhe nuk mund të justifikohen me padijeninë e subjektit.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, në kundërshtim me parashikimin e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, por kjo pasaktësi në deklaram, duke marrë në konsideratë faktin se këto pasuri janë përfitur nga trashëgimia dhe, për rrjedhojë, nuk ka pasur shpenzime për blerjen e tyre, nuk mund të kualifikohet si një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Por lidhur me pasojat e mundshme të këtij mosdeklarimi, Komisioni vlerëson se për sa kohë janë përfitur nga trashëgimia dhe, për rrjedhojë, nuk ka pasur shpenzime për blerjen e tyre, kjo rrethanë nuk përbën shkak në vetvete për të penalizuar subjektin.

9.2 Zyra e Regjistrimit Noterial në Ministrinë e Drejtësisë⁶³ ka informuar mbi një akt noterial, kontratë qiraje datë 4.7.2016, të redaktuar pranë zyrës noteriale të noterit J. Gj, në Bilisht, ku si palë kontraktore paraqitet nëna e subjektit, znj. S.B.

Komisioni i ka kërkuar⁶⁴ subjektit të japë shpjegime në lidhje me këtë marrëdhënie qiraje, për të cilën subjekti ka paraqitur dokumentacion përkatës⁶⁵, ku rezulton se pasuria “arë” me sip. 4.800 m², e fituar me trashëgimi nga nëna e subjektit (1/36 pjesë takuese), është dhënë me qira për një periudhë 19-vjeçare, me qira vjetore në shumën 3,200 lekë. Në kontratën e qirasë palët kanë përcaktuar se vlera e qirasë është likuiduar tërësisht nga qiramarrësi për të gjithë periudhën e qirasë.

⁶¹Deklaratë noteriale nr. ***, datë 20.5.2016, e lëshuar nga znj. S. B.

⁶²Prokurë e posaçme nr. ***, datë 23.5.2016, e lëshuar nga z. E.B.

⁶³Shkresë nr. *** prot., datë 18.10.2019.

⁶⁴Përmes e-mail-it datë 2.6.2021.

⁶⁵Në përgjigje të pyetësorit datë 2.6.2021, subjekti ka depozituar dokumentacion mbështetës: kontratë qiraje nr. ***, datë 4.7.2016, bashkëlidhur ndodhet certifikata e pronësisë dhe kartela e pasurisë nr. ***, “arë” me sip. 4.800 m²; deklaratë noteriale nr. ***, datë 20.5.2016, e lëshuar nga znj. S.B; prokurë e posaçme datë 21.5.2016, e lëshuar nga znj. Z.A; deklaratë noteriale nr. ***, datë 3.6.2021, e lëshuar nga z. B. M.

Kontrata e qirasë datë 4.7.2016 nuk është nënshkruar personalisht nga znj. S.B(nëna e subjektit), pasi kjo e fundit përmes një deklaratë noteriale datë 20.5.2016 i ka dhënë tagra të plota përfaqësimi dhe administrimi të kësaj pasurie vëllait të saj B. M (daja i subjektit), i cili ka nënshkruar kontratën e qirasë në emër dhe për llogari të znj. S. B. Subjekti ka paraqitur edhe një deklaratë noteriale datë 3.6.2021, përmes së cilës z. B. M deklaron se znj. S. B nuk ka pasur dijeni për dhënien me qira të kësaj sipërfaqeje toke.

Në vijim, subjekti ka shpjeguar⁶⁶ se nëna e tij, duke mos pasur interes që në fillim në lidhje me këtë pasuri, ka nënshkruar në datën 23.6.2021 një kontratë dhurimi⁶⁷ përmes së cilës i dhuron vëllait të saj B. M, pjesën e saj takuese të pasurisë së trashëguar.

- ✓ Shpjegimet e subjektit mbi padijeninë e nënës së tij për këtë marrëdhënie qiraje duken bindëse, pasi provohen me dokumentacion mbështetës dhe nisur nga vlera dhe evolimi i kësaj pasuri nuk do të gjendeshin shkaqe për penalizimin e subjektit.

9.3 Shpenzimet e shkollimit të vajzës

Në pyetësozin standard subjekti ka deklaruar mbi shpenzimet e shkollimit të vajzës së tij, në shkollën jopublike 9-vjeçare “F”, Tiranë, për periudhën 2012 – 2017, si vijon:

- pagesë në vitin 2012, në shumën 140.250 lekë, për klasën e parë;
- pagesë në vitin 2013, në shumën 346.500 lekë, për arsimimin e vajzës, A.B, nxënëse në klasën e parë dhe në klasën e dytë;
- pagesë në vitin 2014, në shumën 345.250 lekë, për arsimimin e vajzës, A.B, nxënëse në klasën e dytë dhe në klasën e tretë;
- pagesë në vitin 2015, në shumën 346.000 lekë, për arsimimin e vajzës, A.B, nxënëse në klasën e tretë dhe të katërt;
- pagesë në vitin 2016, në shumën 352.000 lekë, për arsimimin e vajzës, A.B, nxënëse në klasën e katërt dhe të pestë;
- pagesë në vitin 2017, në shumën 328.500 lekë, për arsimimin e vajzës, A.B, nxënëse në klasën e pestë dhe të gjashtë.

Subjekti ka saktësuar se pagesat për arsimimin e vajzës përfshijnë: programin shkollor, ushqimin dhe transportin.

Komisioni⁶⁸ i ka kërkuar subjektit të dokumentojë shpenzimet e kryera për shkollimin e fëmijëve, për të cilat subjekti ka paraqitur dokumentacionin përkatës⁶⁹, që është reflektuar në analizën financiare.

- ✓ Nga verifikimi i kryer, përputhen deklaratimet me dokumentacionin e administruar.

9.4 Komisioni ka verifikuar llogaritë bankare të babait të subjektit

⁶⁶Në shpjegimet e subjektit me e-mail datë 2.7.2021.

⁶⁷Subjekti ka paraqitur kontratë dhurimi nr. ***, datë 23.6.2021.

⁶⁸Përmes e-mail-it datë 2.6.2021.

⁶⁹Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti me nr. *** prot., datë 7.6.2021 dhe nr. *** prot., datë 2.7.2021; vërtetim nr. ** prot., datë 4.6.2021, i shkollës anglo-shqiptare “F”, e cila konfirmon pagesat e tarifave vjetore të shkollimit të vajzës A.B për periudhën 2012 – 2020; vërtetim nr. *** prot., datë 4.6.2021, i shkollës anglo-shqiptare “F”, e cila konfirmon pagesat e tarifave vjetore të shkollimit të djalit T. B për periudhën 2018 – 2020; publikata të pagesave periodike të kryera në llogarinë e shkollës anglo-shqiptare “F” tek “Intesa Sanpaolo Bank” për shkollimin e fëmijëve për periudhën 2012 – 2021.

“Intesa Sanpaolo Bank”⁷⁰ konfirmon se babai i subjektit, z. E.B, ka pasur llogari rrjedhëse në bankë (ish-bankës “Italo-Shqiptare”) të çelur në datën 26.11.2004 dhe me datë mbarimi 9.11.2007, si dhe depozitë bankare në monedhën dollar amerikan, me datë fillimi 15.10.2003 dhe datë mbarimi 26.11.2004. Bashkëlidhur shkresës ndodhet pasqyra e llogarisë bankare.

BKT-ja⁷¹ ka informuar mbi llogaritë rrjedhëse dhe të depozitës së babait, z. E.B, (aktualisht të mbyllura) në monedhat dollar, lekë dhe euro.

Nga verifikimi i llogarive bankare të babait E.B janë evidentuar fonde të mbërritura me transfertë nga jashtë vendit, në shumën totale 46.561 USD, në “Intesa Sanpaolo Bank”, të listuara në tabelën më poshtë për periudhën 2003 – 2004, të cilat nuk janë deklaruar nga subjekti në deklaratimet periodike përkatëse dhe as në deklaratën *Vetting*.

Data	Shuma	Veprimi
7.5.2003	9,985	transfertë në mbërritje nga SHBA-ja
30.9.2003	9,336	transfertë në mbërritje nga SHBA-ja
23.9.2004	19,970	transfertë në mbërritje nga SHBA-ja
1.11.2004	4,990	transfertë në mbërritje nga SHBA-ja
2.11.2004	790	transfertë në mbërritje nga SHBA-ja
23.12.2004	1,490	transfertë në mbërritje nga SHBA-ja
Total	46,561 USD	

Gjithashtu, nga verifikimi i llogarive bankare të babait janë evidentuar depozitime *cash* në monedhat euro dhe dollar në Bankën Kombëtare Tregtare dhe “Intesa Sanpaolo Bank”, siç paraqiten në tabelën vijuese:

Data	Shuma	Monedha	Veprimi	Banka
15.4.2003	2.000	USD	Depozitim <i>cash</i>	Intesa Sanpaolo Bank
3.2.2004	16.240	USD	Depozitim <i>cash</i>	Intesa San Paolo Bank
13.5.2004	16.252	USD	Depozitim <i>cash</i>	BKT
14.4.2005	25.000	USD	Depozitim <i>cash</i>	BKT
9.9.2005	30.000	USD	Depozitim <i>cash</i>	Intesa Sanpaolo Bank
7.5.2007	20.000	EURO	Depozitim <i>cash</i>	BKT

Komisioni⁷² i ka kërkuar subjektit të provojë me dokumentacion mbështetës burimin e këtyre transfertave, marrëdhënien e babait me dërguesin, si dhe destinacionin e tyre.

Subjekti ka shpjeguar⁷³ se nuk ka qenë në dijeni të këtyre veprimeve bankare të kryera nga babai i tij dhe nga komunikimi me të shpjegon se: “*Fondet e mbërritura në monedhën dollar amerikan në ‘Intesa Sanpaolo Bank’, për periudhën kohore të viteve 2003 dhe 2004, në emër të babait, janë dërguar nga tezja e subjektit, shtetasja amerikane Z.A dhe bashkëshorti i saj, shtetasi amerikan Z. A, të cilët janë larguar nga Shqipëria në vitin 1989 në Greqi duke përfutur statusin e refugjatit politik dhe në vitin 1993 kanë emigruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ku banojnë dhe aktualisht. Ajo që më është deklaruar nga babai, ka qenë fakti që ai ka çelur llogarinë bankare të sipërcituar në vitin 2003 me kërkesën e tezes dhe bashkëshortit të saj, me qëllim transferimin e vlerave monetare në llogarinë e babait tim dhe në momentin që do të kërkohej nga këta të fundit për t’i përdorur, sipas qëllimeve të tyre do të tërhiqeshin nga babai.*”

⁷⁰Shkresë nr.*** prot., datë 15.10.2019, të “Intesa Sanpaolo Bank”.

⁷¹Shkresë nr. *** prot., datë 9.10.2019, të BKT-së.

⁷²Përmes e-mail-it datë 27.4.2021.

⁷³Në përgjigje të pyetësorit datë 27.4.2021, mbërritur më 7.5.2021.

Pra, babai im ka qenë vetëm në rolin e pritësit të fondeve dhe të tërheqjes së vlerave monetare sipas kërkesës së tezes dhe bashkëshortit të saj”.

Për sa i përket depozitimeve fizike të vlerave monetare në llogaritë bankare të babait në “Intesa Sanpaolo Bank” dhe në “Banka Kombëtare Tregtare” subjekti ka shpjeguar se: *“Transaksionet bankare janë kryer nga babai me qëllim ruajtjen e këtyre vlerave monetare dhe kthimin e tyre në momentin kur do të kërkoheshin nga tezja dhe bashkëshorti i saj. Vlerat monetare, përjashtuar depozitim fizik të vlerës prej 20.000 euro, më 7.5.2007, në Bankën Kombëtare Tregtare, janë vlera monetare të tezes dhe bashkëshortit të saj dhe babai është kujdesur për t’i ruajtur. Në asnjë moment nga fondet e mbërritura në këto llogari apo të lëvizura në këto llogari nuk ka pasur asnjë përfitim nga babai im, aq më tepër nga unë si subjekt, mbi këto vlera monetare apo edhe mbi interesat e përfituara nga depozitat e krijuara. Llogaritë bankare, përjashtuar depozitim e datës 7.5.2007, janë mbyllur në fillim të vitit 2007 dhe fondet janë kaluar, herë pas here në kohë, për interesat e tyre, te pronarët e tyre të vërtetë, tezja dhe bashkëshorti i saj”.*

Subjekti ka shpjeguar në mënyrë të detajuar transaksionet (depozitim dhe tërheqje) e kryera nga llogaritë e babait të tij, si vijon:

- shuma 16.240 USD, depozituar në “Intesa Sanpaolo Bank”, më 3.2.2004, ka si burim dy tërheqjet e bëra nga babai në këtë bankë të shumave 9.985 USD, më 9.5.2003 (mbërritur me transfertë më 7.5.2003) dhe 9.335,97 USD më 30.9.2003 (mbërritur me transfertë më 30.9.2003);
- shuma 16.252 USD, depozituar në BKT, më 13.5.2004, ka si burim dy tërheqjet e kryera nga babai në “Intesa Sanpaolo Bank” të shumave 5.000 USD, më 12.3.2004 dhe 11.252,03 USD më 13.5.2004;
- shuma 25.000 USD, depozituar në BKT, më 14.4.2005, ka si burim tërheqjen e kryer nga babai në “Intesa Sanpaolo Bank” të shumës 25.344 USD, më 14.4.2005;
- shumat 2.000 USD, depozituar tek “Intesa Sanpaolo Bank”, më 15.4.2003, dhe 30.000 USD, depozituar në këtë bankë më 9.9.2005, kanë pasur si burim fondet e sjella fizikisht nga tezja e subjektit dhe bashkëshorti i saj, gjatë vizitave në Shqipëri që kanë pasur në vitin 2000, ku shuma 30.000 USD është tërhequr brenda muajit më 28.9.2005 dhe shuma 2.000 USD, e tërhequr me mbylljen e llogarisë bankare;
- shuma 20.000 euro, depozituar në BKT, më 7.5.2007, janë kursimet e familjes në vitet 2001 – 2007, të cilat janë përdorur për blerjen e apartamentit në Tiranë, në datën 16.8.2007⁷⁴.

Në vijim, subjekti shpjegon se: *“Fondet e mësipërme dhe lëvizjet në llogari bankare kanë përfunduar në vitin 2007 dhe në momentin e përpilimit të deklaratës Vetting këto fonde nuk ishin, aq më tepër që në asnjë moment nuk janë përdorur si burime për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, të pasqyruara në deklaratën Vetting nga ana ime”.*

Në mbështetje të veprime bankare të mësipërme subjekti ka paraqitur dokumentacionin mbështetës⁷⁵.

⁷⁴Ky transaksion është analizuar më sipër, në pikën 2.5 të vendimit.

⁷⁵Subjekti ka depozituar dokumentacionin si vijon: pasqyrë llogarie bankare me nr. ***, në euro, në emër të z. E.B, në Bankën Kombëtare Tregtare; pasqyrë llogarie bankare me nr. ***, në dollar amerikan, në emër të z. E.B, në Bankën Kombëtare Tregtare; pasqyrë llogarie bankare me nr. ***, në dollar amerikan, në emër të z. E. B, në “Intesa Sanpaolo Bank”; lajmërim kreditimi i lëshuar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, transfertë në mbërritje, të datës 7.5.2003, në llogarinë bankare të z. E.B, për shumën 9.985 USD; lajmërim kreditimi i lëshuar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, transfertë në mbërritje, të datës 30.9.2003, në llogarinë bankare të z. E.B, për shumën 9.335,97 USD; lajmërim kreditimi të lëshuar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, transfertë në mbërritje, të datës 23.9.2004, në llogarinë bankare të z. E.B, për shumën 19.970,00 USD; lajmërim kreditimi i lëshuar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, transfertë në mbërritje, të datës 1.11.2004, në llogarinë bankare të E.B, për shumën 4.990,00 USD; lajmërim kreditimi i lëshuar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, transfertë në mbërritje, të datës 2.11.2004, në llogarinë bankare të z.

i. Komisioni hetoi në lidhje me burimet e ligjshme për dërgesat me transfertë bankare

Komisioni i ka kërkuar⁷⁶ subjektit të provojë me dokumentacion burimin e shumave të dërguara me transfertë dhe *cash* nga tezja e tij, znj. Z. A, me shtetësi amerikane.

Subjekti ka depozituar dokumentacion⁷⁷ provues mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të tezes dhe bashkëshortit të saj, midis të cilave edhe dy deklarata noteriale të lëshuara nga shtetasja Z.A, e cila ka shpjeguar se ka emigruar së bashku me bashkëshortin dhe djalin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës që prej vitit 1993, periudhë në të cilën ka filluar punë në restorant, ndërsa bashkëshorti i saj në ndërtim. Në vitin 2001, znj. Z.A së bashku me bashkëshortin, kanë regjistruar shoqërinë e quajtur “ZAC”, regjistruar me nr. ID ***, në vitin 2001, me aktivitet në fushën e rindërtimit dhe ndërtimit, ku me regjistrimin e shoqërisë kanë hapur edhe llogari bankare për veprimet financiare të saj.

Sipas deklaramit të znj. Z. A, qëllimi i dërgimit të vlerave monetare, nëpërmjet llogarive bankare apo fizikisht, ka qenë për t’i përdorur për blerjen e një sipërfaqeje toke dhe ndërtimin e një shtëpie në qytetin e Tiranës. Por, ky qëllim nuk është realizuar për shumë shkaqe, pasi i është dashur që në disa raste t’i përdorë këto vlera monetare për shpenzime në Shqipëri, siç ka qenë rasti për të rindërtuar shtëpinë e vjetër të bashkëshortit në qytetin e Bilishtit në vitin 2005, apo edhe kriza financiare në SHBA.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni hetoi mbi investime të mundshme të kryera në Shqipëri, nga shtetasja Z.A dhe bashkëshorti i saj, në pasuri të paluajtshme. Nga verifikimi i kryer në sistemin e ASHK-së ka rezultuar vetëm një pasuri me nr. ***, “arë” me sip. 4799 m², me pjesë takuese 1/36 secili, e përfituar me trashëgimi ligjore ku, ndër të tjerë, janë znj. Z.A, së bashku motrën e saj, znj. S.B (nëna e subjektit), ndërsa bashkëshorti i tezes nuk ka rezultuar pronar në ndonjë pasuri të paluajtshme.

ii. Komisioni hetoi për shumat⁷⁸ e sjella fizikisht nga tezja e subjektit dhe familjarë të saj

Për sa i përket depozitimeve *cash* të shumave 2.000 USD, në datën 15.4.2003 dhe 30.000 USD në datën 9.9.2005, të cilat sipas shpjegimeve të subjektit janë sjellë fizikisht nga tezja gjatë vizitave në Shqipëri në vitet 2000, Komisioni i ka kërkuar⁷⁹ subjektit të depozitojë dokumentacion mbi deklaramin e këtyre shumave *cash*, nga znj. Z.A apo bashkëshorti i saj, në pikat e kalimit kufitar në Shqipëri dhe SHBA.

Subjekti ka shpjeguar⁸⁰ se: *“Në kuadër të pyetësorit të mësipërm kam komunikuar me tezen, e cila më ka shpjeguar se shuma prej 30.000 USD, depozituar në llogari bankare nga babai në fillim të muajit shtator të vitit 2005, nuk është shumë e sjellë në atë periudhë kohore, por e sjellë fizikisht ndër vite, ku ajo dhe familjarë të saj kanë udhëtuar në drejtim të Shqipërisë. Sipas tezes Z. A, një pjesë e shumës prej 30.000 USD janë sjellë nga këta të fundit në fillim të muajit shtator të vitit 2005, pa më specifikuar shumën e saktë, për shkak të kohës të largët, në momentin kur kanë ardhur në Shqipëri për të marrë pjesë në ceremoninë e dasmës time. Sipas tezes ka qenë dëshira e tyre që kjo shumë të depozitohet në llogari bankare nga babai.*

E.B, për shumën 790 USD; lajmërim kreditimi i lëshuar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, transfertë në mbërritje, të datës 23.12.2004, në llogarinë bankare të shtetasit E.B për shumën 1.490,00 USD; lajmërim kreditimi i lëshuar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, transfertë në mbërritje, të datës 23.12.2004, në llogarinë bankare të shtetasit E. B, për shumën 1.490,00 USD.

⁷⁶Përmes pyetësorit datë 25.6.2021.

⁷⁷Dokumentacion i depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit datë 25.6.2021, administruar në Komision me nr. *** prot., datë 2.7.2021: deklaratat noteriale të datave 21.6.2021 dhe 25.6.2021, të shtetasës Z.A (tezja e subjektit) e nënshkruar para noteres A.O; deklaratat tatimore të të ardhurave individuale në SHBA, për shtetasit Z dhe Z.A, për periudhën 1999 – 2005, të përkthyer me vërtetim përkthimi datë 28.6.2021.

⁷⁸Shuma 2.000 USD e depozituar më 15.4.2003 dhe shuma 30.000 USD e depozituar më 9.9.2005.

⁷⁹E-mail datë 1.7.2021.

⁸⁰E-mail datë 5.7.2021 në përgjigje të pyetësorit datë 1.7.2021.

Meqenëse në këtë periudhë kohore kanë pasur nevojë për vlera monetare për rregullimin e banesës që kanë në qytetin e Bilishtit, si dhe me kërkesën e të afërmeve të burrit të tezes, Z. A, në qytetin e Bilishtit për vlera monetare, me kërkesën e tezes dhe bashkëshortit të saj, babai ka tërhequr këtë shumë brenda muajit shtator të vitit 2005”.

Në vijim, subjekti ka shpjeguar se: *“Në lidhje me kalimin e vlerave monetare fizikisht në pikat e kalimit kufitar ne Republikën e Shqipërisë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si në ardhje ashtu edhe në shkuarje, tezja më ka shpjeguar se në çdo rast ajo dhe familjarë të saj kanë respektuar kufirin e detyrueshëm të deklaramit të vlerave monetare përpara autoriteteve doganore respektive, ku me sa mban mend, në asnjë rast nuk ka qenë e detyruar apo t’i jetë kërkuar deklarimi i vlerave monetare. Tezja më ka premtuar se për këtë qëllim do të interesohet më tepër dhe mund të më dërgojë informacion brenda javës, informacion të cilin do t’ua bëj të ditur në vijim”.*

Nga të dhënat e gjeneruara nga sistemi TIMS, duke filluar nga viti 2004 ka rezultuar se shtetasit Z dhe Z.A, si dhe dy djemtë e tyre, kanë hyrë dhe dalë nga territori i Shqipërisë në vitin 2005, ku duket se data e depozitimit *cash* të shumës 30.000 USD nga babai i subjektit korrespondon me praninë fizike të tezes dhe bashkëshortit në Shqipëri (me datë hyrje 10.8.2005 dhe datë dalje 10.9.2005), por nuk provohet me dokumentacion që këto shuma të jenë sjellë fizikisht nga tezja e subjektit.

iii. Lidhur me destinacionin dhe kohën e kthimit të shumave tezes së subjektit

Subjektit iu kërkuar shpjegime nga Komisioni mbi destinacionin e parave të dërguara, si dhe kthimi mbrapsht i këtyre shumave. Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të tij, ka depozituar deklaratë noteriale të datës 25.6.2021, ku tezja e subjektit, znj. Z.A, ka deklaruar se: *“Të gjitha vlerat monetare të cilat janë depozituar që prej vitit 2002 deri në vitin 2007 në llogaritë e bashkëshortit të motrës, z. E.B, si dhe ato të sjella fizikisht here pas here në Shqipëri, të depozituara në llogari bankare, kryesisht në vitin 2005 dhe të tërhequra po atë vit nga E. B, janë vlera monetare të miat, bashkëshortit tim dhe djemve të mi. Të gjitha vlerat monetare, të depozituara dhe të tërhequra nga E.B, janë marrë nga unë dhe familjarë të mi fizikisht pas vitit 2007, herë pas here, por jo më vonë se viti 2012”.*

Komisioni verifikoi nëse tezja apo familjarët e saj (bashkëshorti dhe djemtë) kanë qenë në Shqipëri gjatë periudhës 2007 – 2012 dhe nëse datat e mbylljes së këtyre llogarive korrespondojnë me praninë fizike të tyre në Shqipëri.

Nga verifikimi i të dhënave të gjeneruara nga sistemi TIMS ka rezultuar se shtetasja Z.A ka hyrë në shtetin shqiptar në vitet 2005, 2007 dhe 2012, konkretisht, në vitin 2005 ka datë hyrje 10.8.2005 dhe datë dalje 10.9.2005, në vitin 2007, datë hyrje 1.8.2007 dhe datë dalje 26.8.2007, si dhe në vitin 2012, datë hyrje 13.8.2012 dhe datë dalje 27.8.2012.

Në tabelën vijuese janë paraqitur të dhëna mbi datat e hapjes dhe mbylljes së këtyre llogarive në emër të babait të subjektit, vlerat për secilën llogari me gjendjet në fund të çdo viti.

Pershkrimi	Data e hapjes se llogarise	2003	2004	2005	2006	2007	Data e mbylljes
BKT depozite ne euro	7.5.2007					-	13.8.2007
BKT depozite ne USD	13.5.2004		1 355 331,40	3 985 644,76	1 793 727,00	-	30.1.2007
ISP (ish BIA) llogari ne USD	15.4.2003	217 380,00	2 586 266,46	223 502,79		-	3.11.2006
Total gjendjet ne leke ne 31 Dhjetor		217 380	3 941 598	4 209 148	1 793 727	-	

- ✓ Nga sa më sipër, duket se datat e mbylljes së llogarive korrespondojnë me praninë fizike të tezes në Shqipëri, vetëm me një llogari pa gjendje monetare, të mbyllur në gusht të vitit 2007.

Komisioni i kërkoi⁸¹ subjektit të rivlerësimit të depozitave *statement* bankare të llogarive të tezes Z.A dhe bashkëshortit të saj, për të ardhurat familjare të ligjshme në llogaritë e tyre, për periudhën 2000 – dhjetor 2012.

Subjekti⁸², në përgjigje, nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar nga Komisioni dhe ka shpjeguar, ndër të tjera, se: *“Në lidhje me pasqyrat financiare të llogarive bankare kam hasur në hezitimin e të afërmeve të mi për dërgimin e tyre. Pasi nga komunikimi me avokatin e tyre, u është dukur jo e rregullt dërgimi i të dhënave personale në mënyrë indirekte, nëpërmjet meje Komisionit. Megjithatë, të afërmit e mi më kanë premtuar se u janë drejtuar institucioneve bankare respektive në lidhje me kërkimin dhe në vijim do të më dërgojnë të dhënat”.*

- ✓ Nga hetimi i kryer, duket se datat e mbylljes së llogarive në vitin 2007 korrespondojnë me praninë fizike të znj. Z.A në Shqipëri. Nuk ka të dhëna të dokumentuara që këto likuiditete t’i jenë kthyer tezes së subjektit apo të jetë dokumentuar kthimi i këtyre vlerave monetare në SHBA.

iv. Komisioni analizoi mundësitë financiare të tezes së subjektit dhe familjarëve të saj

Komisioni, për ta bërë sa më shterues hetimin, megjithëse këto para nuk janë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie të subjektit, ka analizuar mundësitë financiare të tezes dhe familjes së saj për dërgimin e shumave *cash* apo me transfertë bankare. Subjekti ka depozituar dokumentacion në lidhje me deklaratat tatimore të të ardhurave individuale në SHBA, të tezes Z.A dhe bashkëshortit Z.A, për periudhën 1999 – 2005.

Përshkrimi	1999 – 2005 (vlerat në USD)
Total të ardhura <i>neto</i> Z dhe Z. Ai	182 903,00
Shpenzime jetese për 4 persona	129 218,00
Të ardhura minus shpenzime	53 685,00
Shuma të dërguara babait të subjektit të rivlerësimit	78 560,97
Mundësi për të dërguar para	- 24 875,97

Nga analizimi i të ardhurave familjare të tezes së subjektit, për vitet 1999 – 2005, mundësia financiare e tezes së subjektit për të kryer transfertat dhe dërguar para *cash*, ndër vite, duket se ka një balancë negative në shumën 24.876 USD.

Nga hetimi i kryer:

- Ngrihen dyshime mbi destinacionin dhe kthimin e vlerave monetare tezes së subjektit, në total, janë në shumën 78.561 USD.
- Duket se teza dhe familjare të saj kanë pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme në shumën 24.875 USD, për shumën e dërguara në Shqipëri.

Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës.

Qëndrimi i subjektit

a. Në lidhje me pamjaftueshmërinë e burimit të ligjshëm të vlerave monetare të dërguara nga teza, subjekti ka prapësuar se nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, nuk është marrë

⁸¹E-mail datë 24.9.2021.

⁸²Përmes e-mail-it datë 30.9.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 24.9.2021.

në konsideratë mundësia e kursimit të tezes Z.A dhe bashkëshorti Z.A për periudhën 23.5.1993 – 31.12.1998. Nisur nga fakti se ka kaluar një kohë mbi 20-vjeçare, subjekti e ka të pamundur të dokumentojë mundësinë e kursimit dhe të ardhurave të tezes për periudhën 1993 – 1998. Për rrjedhojë, subjekti kërkon që Komisioni të marrë në konsideratë gjendjen në fillim/ose mundësinë e kursimit deri në vitin 1998, qoftë edhe bazuar në ndonjë metodë alternative përlllogaritjeje.

Me qëllim përmbushjen e çdo detyrimi të kërkuar nga Komisioni lidhur me paraqitjen e statementit bankar të tezes në SHBA, subjekti ka shpjeguar se nga informacioni i marrë nga banka, këto të dhëna nuk janë të disponueshme për periudhën mbi 7 vjet përpara datës së kërkit. Në seancën dëgjimore të datës 25.10.2021, subjekti ka depozituar kopje të përgjigjes së bankës dhe shërbimit postar⁸³, ku provohet se ky dokument bankar është dërguar me postë dhe pritët të mbërrijë nga shërbimi postar.

Në kushtet e pamundësisë objektive për të paraqitur akte të tjera shkresore për të ardhurat e siguruara nga teza, subjekti ka kërkuar që të mbahen parasysh parashikimet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, pasi ndodhet në pamundësi objektive për të siguruar këtë dokumentacion.

Subjekti pretendon se Komisioni duhet të korrigjojë shpenzimet jetike të llogaritura për 4 persona, për periudhën 1999 – 2005, pasi njëri prej djemve të tezes, E.A, ka shkuar në SHBA në vitin 2001 dhe në deklaratimet e viteve 1999, 2000 dhe 2005 teza ka deklaruar si person në ngarkim vetëm njërin prej djemve, I.A, ndërsa për vitet 2001 – 2004 teza ka pasur në ngarkim të dy djemtë, të cilët janë deklaruar në IRS, ndërsa në vitin 2005 nuk është deklaruar djali E. A, pasi është ndarë nga teza duke punuar dhe jetuar më vete.

Sa më sipër, sipas subjektit, pamundësia për të dërguar para nga analiza financiare është në vlerën -8,723.97 USD, e cila duhet të vlerësohet si e parëndësishme/e vogël në raport me shumën gjithsej të dërguar dhe fakti se Komisioni ka konsideruar vitin 1999 si pikën zero.

b. Sa i takon dyshimit mbi destinacionin dhe kthimin e vlerave monetare tezes së subjektit, për të cilën i është ngarkuar barra e provës, subjekti ka shpjeguar se duke u nisur nga fakti se shumat e dërguara janë të gjitha të tërhequra dhe pjesa më e madhe e shumës është dërguar prej tezes me bankë, heq çdo dyshim mbi kthimin e këtyre shumave, për sa kohë këto shuma nuk janë përdorur asnjëherë as nga subjekti dhe as nga prindërit e tij në krijimin e ndonjë pasurie të luajtshme apo të paluajtshme. Subjekti ka saktësuar se shumat me transfertë bankare janë kontrolluar nga banka dërguese dhe shteti dërgues për burimin e krijimit të tyre dhe ligjshmërinë e të ardhurave.

Si përfundim, në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të tezes, subjekti vlerëson se Komisioni duhet të marrë në konsideratë faktin se shuma e depozituar në llogarinë e babait nuk është konsideruar nga babai asnjëherë si likuiditet i tij, nuk është përdorur asnjëherë prej tij dhe nuk ka pasur asnjë ndikim në pasuritë e krijuara nga babai, përfshi edhe shpenzimet familjare, si dhe është kthyer përpara plotësimit të deklaratës *Vetting*, për të cilën nuk është i ngarkuar nga ligji për të justifikuar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie sepse teza në kushtet e sipërcituara nuk mund të konsiderohet person tjetër i lidhur.

Vlerësimi i Komisionit

Nisur nga sa ka rezultuar nga dokumentacioni i administruar dhe duke mbajtur në vëmendje edhe përgjigjet e subjektit ndaj pyetësorëve, si dhe shpjegimet e paraqitura nga ky i fundit pasi është njohur me rezultat e hetimit administrativ, Komisioni çmon se nuk është provuar burimi

⁸³Dokumente të paraqitura nga subjekti në seancën dëgjimore datë 25.10.2021, si vijon: kopje vërtetimi datë 10.10.2021, i shtetases Z. A (teza e subjektit); kopje e fotografuar e mandatit të shërbimit postar “U.S.P.S”; kopje e dokumentit bankar “PNC Bank”, datë 5.10.2021, drejtuar shtetases Z.A.

i ligjshëm, prejardhja dhe destinacioni final i shumave të konsiderueshme monetare, të disponuara në llogaritë bankare të babait të subjektit të rivlerësimit. Komisioni ka arritur në këtë konkluzion për sa kohë shpjegimet e subjektit kanë rezultuar jobindëse, kontradiktore dhe pa arsye logjike dhe ekonomike të besueshme.

Konkretisht dhe kryesisht, lidhur me të gjitha shumat e depozituara *cash* nga babai i subjektit në llogaritë e tij bankare, si vijojnë, nuk është provuar burimi i ligjshëm i tyre.

15.4.2003	2,000	USD	Depozitim <i>cash</i>	Intesa Sanpaolo Bank
3.2.2004	16,240	USD	Depozitim <i>cash</i>	Intesa Sanpaolo Bank
13.5.2004	16,252	USD	Depozitim <i>cash</i>	BKT
14.4.2005	25,000	USD	Depozitim <i>cash</i>	BKT
9.9.2005	30,000	USD	Depozitim <i>cash</i>	Intesa Sanpaolo Bank
7.5.2007	20,000	EURO	Depozitim <i>cash</i>	BKT

Gjithashtu, nuk është provuar se kush ka qenë prejardhja e këtyre shumave të konsiderueshme monetare, të disponuara për shumë vite, nga viti 2003, në llogaritë e babait të subjektit, ndërkohë që ky i fundit ishte me detyrë prokuror, prej vitit 2001, në mungesë të burimeve të ligjshme financiare sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pa u provuar pretendimi se ato shuma i përkisnin tezes së subjektit dhe se ishin transferuar nga kjo e fundit nga ShBA-ja në Shqipëri, personalisht apo nëpërmjet personave të tretë.

Lidhur me këtë pretendim vërehet mangësia e një sërë përgjigjesh dhe shpjegimesh bindëse dhe të besueshme, mbi disa pyetje që rrjedhin nga konteksti rrethanor, si dhe nga kontradiktoriteti i pretendimeve dhe nga mungesa e logjikës ndërlidhëse të dinamikës së paraqitur nga subjekti dhe nga tezja e tij, nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 25.6.2021, ku ka deklaruar se: “*Të gjitha vlerat monetare që janë depozituar që prej vitit 2002 deri në vitin 2007 në llogaritë e bashkëshortit të motrës, z. E. B, si dhe ato të sjella fizikisht herë pas herë në Shqipëri të depozituara në llogari bankare kryesisht në vitin 2005 dhe të tërhequra po atë vit nga E. B, janë vlera monetare të miat, bashkëshortit tim dhe djemve të mi. Të gjitha vlerat monetare, të depozituara dhe të tërhequra nga E. B, janë marrë nga unë dhe familjarë të mi fizikisht pas vitit 2007, herë pas herë, por jo më vonë se viti 2012*”.

Konkretisht, mbeten pa përgjigje dhe shpjegime bindëse e logjike pyetjet si në vijim: (i) në çfarë mënyre, nga kush dhe kur janë futur në territorin shqiptar shuma të konsiderueshme monetare; (ii) a janë deklaruar ato në kufijtë dalës dhe hyrës; (iii) përse ato nuk janë përcjellë nëpërmjet sistemit bankar, sikurse është bërë në raste të tjera; (iv) përse nuk rezultojnë derdhje në llogari në datat që tezja rezulton të ketë ardhur në Shqipëri; (v) përse ajo nuk i depozitoi në llogari bankare të vetën, kur dhe për sa kohë ishte vetë prezente në Shqipëri, por i linte në llogari të një personi të tretë, për sa kohë nuk do të përdorëshin prej këtij të fundit; (vi) përse nuk u përdorën kurrë në territorin shqiptar, nëse kishin mbërritur vërtetë nga SHBA-ja për këtë arsye; (vii) përse nuk u rimorën mbrapsht *cash* (sipas pretendimit) nga babai i subjektit, në vitin 2007, rreth 75.000 USD, nuk u transferuan nëpërmjet sistemit bankar në SHBA – për sa kohë ishin me burim të ligjshëm; (viii) a janë deklaruar ato në kufijtë dalës dhe hyrës dhe a lejohej transferimi i një shume të tillë valute *cash*; (ix) nëse nuk janë transferuar njëherazi në SHBA, si dhe kur janë mbajtur deri sa janë transferuar dhe përse janë marrë paraprakisht nga babai i subjektit; (x) përse ky i fundit i ka tërhequr shumat në fjalë nga bankat përkatëse shumë kohë përpara se të vinte tezja e subjektit nga SHBA-ja dhe jo në momentin/periudhën që ajo ishte prezente në territorin shqiptar, 1 - 26 gusht 2007, dhe mund t’i merrte në dorëzim shumat e pretenduara.

Lidhur me shpjegimin e shkakut të transferimit të këtyre shumave nga SHBA-ja se prej familjes së tezes ishte në plan që të blihej një pasuri në Shqipëri, Komisioni çmon se nuk është bindës pasi nuk kuptohet përse duhej që shumat në fjalë të niseshin të pjesshme shumë vite më herët, duke humbur edhe interesat bankare dhe të mos transferoheshin në momentin e duhur, njëherazi apo me transfertat të njëpasnjëshme në prag të investimit real – kur dhe nëse do të konkretizohej. Sikurse mbetet pa një shpjegim bindës mosinvestimi në Shqipëri dhe sidomos mënyra dhe koha e kthimit/transferimit në SHBA të shumave të konsiderueshme monetare – sikurse pretendohet por nuk provohet. Lidhur me këtë paqartësinë e fundit, i pyetur nga vëzhguesi ndërkombëtar në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit u shpreh se nuk ishte në gjendje të jepte një përgjigje, pasi ishte në padijeni të këtyre rrethanave.

Nisur nga sa më sipër është përshkruar edhe nga mungesa e përgjigjeve bindëse të pyetjeve të lartpërmendura, si dhe në mungesë të ndonjë prove konkrete për sa pretendohet, Komisioni krijon bindjen se shumat e derdhura *cash* nga babai i subjektit, në llogaritë e veta bankare, janë pasuri e luajtshme e familjes së subjektit të rivlerësimit, pa burime të ligjshme financiare dhe, për këtë shkak, subjekti ka tentuar të evitojë verifikimin dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pamjaftueshmëria financiare, duke pretenduar se ato nuk ishin shuma monetare të familjes së tij, por të tezes, pa arritur ta provojë këtë rrethanë.

Në këtë pikë, Komisioni çmon se problematika e konstatuar në këtë pikë, lidhur me pamundësinë e mjeteve monetare të ligjshme për depozitat e krijuara me derdhje të shumave të konsiderueshme *cash* nga babai i subjektit, në një periudhë kur subjekti ushtronte detyrën si prokuror - e konsideruar së bashku me problematikën e tjera të kriterit të pasurisë, rezultoi e mjaftueshme për aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pa qenë nevoja e analizës së mundësive financiare të tezes së subjektit për të disponuar me burime të ligjshme shuma të transferuara nëpërmjet sistemit bankar, gjithmonë në llogaritë bankare të babait të subjektit. Përpos paqartësive mbi shkaqet e transferimit dhe burimit të ligjshëm të këtyre shumave, si dhe mungesës së provës mbi faktin se ato janë marrë mbrapsht prej saj, si dhe mbi mënyrën dhe kohën e (ri)transferimit të tyre në SHBA, Komisioni çmon se në çdo rast, edhe nëse do të provohesh pretendimi i subjektit për këtë pjesë, kjo nuk do ta ndryshonte vlerësimin përfundimtar dhe vendimmarrjen për subjektin e rivlerësimit.

9.5 Komisioni verifikoi lidhur me të dhënat e gjeneruara nga sistemi TIMS

Në lidhje me udhëtimet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nga sistemi TIMS⁸⁴ ka rezultuar se subjekti ka udhëtuar me 4 automjete të ndryshme, me targa: DV *** A, KSMC ***, WUR *** dhe NDP ***.

Komisioni i ka kërkuar⁸⁵ subjektit të shpjegojë pronësinë e automjeteve me të cilët ka udhëtuar, si dhe marrëdhënien me pronarët respektivë.

Subjekti ka dhënë shpjegimet⁸⁶ përkatëse për secilin automjet me të cilin ka udhëtuar në shtetin grek, kryesisht udhëtime në vitin 2008 (për arsye shëndetësore), duke sqaruar se:

*“Automjeti me targa KSMC ***, me të cilin kam dalë në Greqi më 8.10.2008, është në pronësi të shtetasit A. A, banor i qytetit të Tiranës dhe pronar i klinikes mjekësore ‘D’ në qytetin e Tiranës. Njohja dhe shoqëria me këtë shtetas ka qenë rastësore që prej vitit 2004 në kohën kur kam ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ku klinika në pronësi të këtij shtetasi ka qenë përballë me vendin e punës dhe frekuentonim lokal në pronësi të këtij shtetasi, i cili ndodhej në të njëjtën godinë.*

⁸⁴Shkresë nr. *** prot., datë 28.4.2021.

⁸⁵E-mail datë 26.4.2021.

⁸⁶Kthyer përgjigje me e-mail datë 29.4.2021.

*Në lidhje me automjetin me targa DV *** A, me të cilin kam dalë në Greqi më 4.11.2008, ky automjet është në pronësi të shtetasit K. R. M, i afërm i nënës time, djali i xhaxhait, banor i qytetit të Bilishtit, Devoll.*

*Në lidhje me automjetin me targa DV *** A, me të cilin kam dalë në Greqi më 27.11.2008, ky automjet është në pronësi të shtetasit A. A.K, i datëlindjes 16.8.2008, kunati i vajzës së hallës time, shtetases M. K, banor i qytetit të Bilishtit, Devoll.*

*Në lidhje me automjetin me targa DV *** A, me të cilin kam hyrë në Greqi më 18.12.2008, ky automjet është në pronësi të shtetasit U. E. P, i datëlindjes 16.12.1967, i afërm i nënës sime, djali i dajës, banor i fshatit P, Devoll.*

*Në lidhje me automjetin me targa NHP ***, me të cilin kam hyrë më 29.11.2008, ky automjet është përdorur nga ana ime si shërbim taksi kundrejt pagesës së një shume prej 100 euro.*

*Ndërsa për sa i përket automjetit me targa WUR ***, subjekti ka sqaruar se bëhet fjalë për automjetin tip 'Mercedes-Benz' në pronësi të tij, i cili është targuar më vonë me targën AA *** HA”.*

- ✓ Në lidhje me udhëtimet e kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, shpjegimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e përcjellë nga sistemi TIMS dhe me verifikimet e targave të sistemi i AMF-së.

Në lidhje me konfliktin e interesit, Komisioni i ka kërkuar subjektit të deklarojë dhe depozitojë dokumentacion mbështetës, nëse ka pasur në funksionin e prokurorit çështje penale të pushuara apo të mosfilluara, apo të dërguara për gjykim lidhur me shtetasin A. A, si pronar i automjetit me të cilin ka udhëtuar në Greqi.

Në prapësimet e datës 19.10.2021, subjekti ka depozituar dokumentacion mbështetës⁸⁷ nga prokuroritë ku ka ushtruar detyrën si prokuror, ku rezulton se nuk ka hetuar, apo përfaqësuar organin e akuzës në ndonjë çështje penale në ngarkim të shtetasit A. A.

Subjektit iu kërkuar shpjegime lidhur me shpenzimet e udhëtimeve në shtetin grek

Subjekti ka shpjeguar⁸⁸ mbi udhëtimet e kryera prej tij dhe familjarëve në shtetin grek për shkak të kryerjes së disa vizitave mjekësore dhe trajtimit mjekësor të tij: *“Udhëtimet e mia në Greqi, shoqëruar nga bashkëshortja ime, E. B, për periudhën kohore nga muaji tetor i vitit 2008 deri në muajin dhjetor të vitit 2008, kanë të bëjnë me faktin që në këtë periudhë kohore jam diagnostikuar me sëmundjen e tumorit. Udhëtimet në Greqi kanë qenë me qëllim të kryerjes së vizitave mjekësore dhe trajtimit mjekësor”.*

Subjekti ka depozituar dokumentacion provues⁸⁹ lidhur me shpenzimet mjekësore të kryera në spitalin “D”, Selanik.

⁸⁷Dokumentacion i depozituar nga subjekti me prapësimet e datës 19.10.2021, si vijon: shkresë nr. ***-A prot., datë 8.10.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 12.10.2021, e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; shkresë nr. *** prot., datë 8.10.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë;

⁸⁸Në përgjigje të pyetësorit datë 26.4.2021, protokolluar me nr. *** prot., datë 29.4.2021.

⁸⁹Subjekti ka dërguar dokumentacionin e përkthyer dhe njehsuar me origjinalin si vijon: faturë me nr. serie ***, datë 15.10.2008, në vlerën 4.918.87 euro; faturë ofrim shërbimesh me nr. serie ***, datë 15.10.2008; faturë me nr. serie ***, datë 15.10.2008, në vlerën 588 euro; faturë ofrim shërbimesh me nr. serie ***, datë 15.10.2008, në vlerën 588 euro; faturë me nr. serie ***, datë 7.11.2008, në vlerën 917.76 euro; faturë ofrim shërbimesh me nr. serie OD ***, datë 4.11.2008, në vlerën 35 euro; faturë me nr. serie ***, datë 7.11.2008, në vlerën 85.95 euro; faturë ofrim shërbimesh me nr. serie ***, datë 7.11.2008; faturë ofrim shërbimesh me nr. serie ***, datë 7.11.2008, në vlerën 917.76 euro; faturë me nr. serie ***, datë 29.11.2008, në vlerën 1.288,89 euro; faturë me nr. serie ***, datë 20.12.2008, në vlerën 120.88 euro; faturë me nr. serie ***, datë 20.12.2008,

Shpenzimet mjekësore janë reflektuar në analizën financiare sipas dokumentacionit mbështetës të depozituar. Nga analiza e kryer për vitin 2008 ka rezultuar një balancë negative në shumën 104.671 lekë (shihni tabelën përmbledhëse). Në lidhje me këtë balancë negative, subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti ka dhënë shpjegimet e tij me prapësimet e depozituara më 19.10.2021, duke shpjeguar, ndër të tjera, se: *“Në analizën financiare të vitit 2008 duhet që shpenzimet jetike të miat dhe bashkëshortes duhet të korrigjohen në ulje, për ditët e qëndrimit në Greqi, gjatë periudhës nëntor dhe dhjetor, kur kam qenë në Greqi për kurim dhe në shpenzimet e qëndrimit dhe kurimit janë përfshirë edhe shpenzimet jetike. Gjithashtu, fakti se analiza financiare rezulton me humbje vjen edhe për arsyen se pasi jam diagnostikuar me tumor kam pasur vizita nga të afërm, shokë dhe kolegë, të cilët kanë kontribuar secili në shuma të vogla”.*

Vlerësimi i Komisionit

Lidhur me sa më lart, Komisioni vlerëson se është bindës dhe pranohet pretendimi i subjektit lidhur me mospërlllogaritjen e shpenzimeve jetike për subjektin dhe bashkëshorten e tij, për periudhat që kanë qenë jashtë shtetit, pasi përlllogaritja e dyfishtë do të përkeqësonte analizën financiare pa të drejtë. Ky ndryshim është përfshirë në tabelën e përgjithshme të analizës financiare, ndonëse rezulton se përmirësimi i pamundësisë është minimal dhe nuk influencon në rezultatin final edhe sikur të pranoheshin të gjitha pretendimet e subjektit në këtë pikë – pasi lidhur me kontributet e personave të tretë, përpos mungesës së provës, ato as nuk janë deklaruar/saktësuar në masën e tyre të saktë.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE TË SUBJEKTIT

Subjekti i rivlerësimit, lidhur me të ardhurat e tij, ka deklaruar si vijon:

- bursë e përfitur nga Shkolla e Magjistraturës, Tiranë, për periudhën 1998 – 2000 dhe shuma e të ardhurave *neto* të krijuara është 441.810 lekë;
- paga në funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendndodhje në rrugën “Haxhi Dalliu”, për periudhën tetor 2000 – tetor 2001 dhe shuma e të ardhurave *neto* të krijuara është 507.212 lekë;
- paga në funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për periudhën tetor 2001 - prill 2004 dhe shuma e të ardhurave *neto* të krijuara është 1.592.510 lekë;
- paga në funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, për periudhën prill 2004 - qershor 2008 dhe shuma e të ardhurave *neto* të krijuara është 5.270.749 lekë;
- paga në funksionin e prokurorit në prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën qershor 2008 – shtator 2016 dhe shuma e të ardhurave *neto* të krijuara është 10.591.716 lekë.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- vërtetim nr. *** prot., datë 24.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës për të ardhurat e subjektit Ardian Braho për periudhën 1998 – 2000, në shumën 441.810 lekë;
- vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, në lidhje me të ardhurat *neto* për periudhën 1.10.2001 – 1.4.2004, në shumën totale 1.592.510 lekë;

në vlerën 77.48 euro; faturë ofrim shërbimesh nr. ***, datë 20.12.2008; faturë ofrim shërbimesh nr.***, datë 20.12.2008, në vlerën 920,88 euro.

- vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, datë 12.10.2016, në lidhje me të ardhurat *neto* për periudhën janar 2004 – qershor 2008, në shumën totale 5.270.749 lekë;
- vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 12.10.2016, në lidhje me të ardhurat *neto* për periudhat, tetor 2000 – tetor 2001 dhe qershor 2008 – shtator 2016, në shumën totale 11.098.928 lekë.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE PËR BASHKËSHORTEN/E.B

Subjekti i rivlerësimit, lidhur me të ardhurat e bashkëshortes si person tjetër i lidhur, ka deklaruar si vijon:

- paga si specialiste në OJF-në “Sh.K.Sh.K” Tiranë, me administratore shtetasen L.D, në vitin 2008 (nuk disponon dokumentacion justifikues) dhe shuma e të ardhurave *neto* të krijuara 3.000 USD;
- paga si specialiste në arkivin e universitetit jopublik “K”, Tiranë, për periudhën korrik 2010 – maj 2013 dhe shuma e të ardhurave *neto* të krijuara është 1.693.744 lekë;
- paga si specialiste në Bashkinë Tiranë në Drejtorinë e Licencimit dhe Gjendjes Civile, për periudhën maj 2013 – dhjetor 2016 dhe shuma e të ardhurave *neto* të krijuara është 2.058.187 lekë.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- nxjerrje llogarie nga “Union Bank”, datë 27.10.2016, në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes për periudhën korrik 2010 – shtator 2012, në shumën 1.523.724 lekë;
- lajmërim kreditimi nga “Intesa Sanpaolo Bank”, në datat 6.12.2012, 21.12.2012, 29.1.2013, 7.2.2013, 8.3.2013, 9.5.2013, 10.6.2013 dhe 22.7.2013, në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes nga shoqëria “K” sh.p.k., për periudhën tetor 2012 – maj 2013 në shumën 170.025 lekë;
- vërtetimin nr. *** prot., datë 11.1.2017, nga Bashkia Tiranë, në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes E.B, për periudhën 2013 – 2016, në shumën totale *neto* 2.058.187 lekë.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE PËR BABAIN E SUBJEKTIT/E.B

Subjekti i rivlerësimit, lidhur me të ardhurat e babait të tij si person tjetër i lidhur, ka deklaruar si vijon:

- pension i parakohshëm për periudhën qershor 2001 – qershor 2003 dhe shuma e të ardhurave *neto* të krijuara është 242.811 lekë;
- pension suplementar për periudhën qershor 2003 - janar 2017 dhe shuma e të ardhurave *neto* të krijuara është 1.795.007 lekë;
- pension pleqërie për periudhën prill 2006 – janar 2017 dhe shuma e të ardhurave *neto* të krijuara është 2.513.199 lekë;
- paga në detyrën e punonjësit të sigurisë fizike pranë shoqërisë së ruajtjes fizike “S.M”, pranë Drejtorisë së Tatimeve Tiranë me administrator shtetasin S.M, për periudhën shtator 2001 – 2003 (nuk disponon dokumentacionin përkatës) dhe shuma e të ardhurave *neto* të krijuara është 420.000 lekë;

- paga në detyrën e punonjësit të sigurisë fizike pranë shoqërisë së ruajtjes fizike “N.S”, në bulevardin “Zogu i Parë”, nr. **, me administrator shtetasin A.N, për periudhën janar 2004 – tetor 2007 dhe shuma e të ardhurave *neto* të krijuara është 920.000 lekë;
- paga në detyrën e magazinierit në Kombinatin e Mishit Yzberisht, Tiranë, me administrator shtetasin G. L, për periudhën nëntor 2007 – prill 2010 (nuk disponon dokumentacionin përkatës) dhe shuma e të ardhurave *neto* të krijuara është 750.000 lekë.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- vërtetimin për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare të babait E.B, lëshuar nga ISSH-ja, për periudhën 1.6.2001 – 1.6.2003, në shumën totale *bruto* 242.811 lekë;
- vërtetimin nr. *** prot., datë 20.1.2017, nga ISSH-ja, në lidhje me të ardhurat e pensionit suplementar të babait për periudhën 1.6.2003 – 31.12.2017, në shumën totale 1.795.007 lekë;
- vërtetimin nr. *** prot., datë 20.1.2017, nga ISSH-ja, në lidhje me të ardhurat e pensionit të pleqërisë të babait për periudhën 3.4.2006 - 31.12.2017, në shumën totale 2.513.199 lekë;
- vërtetimin e pagës nga shoqëria N.S.S (N.S.S), në lidhje me të ardhurat e babait për periudhën 1.1.2004 – 30.10.2007, në shumën 15.000 - 20.000 lekë/muaj.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE PËR NËNËN E SUBJEKTIT/S. B

Subjekti i rivlerësimit, lidhur me të ardhurat e nënës, ka deklaruar si vijon:

- pension pleqërie për periudhën maj 2004 – janar 2017 dhe shuma e të ardhurave *neto* të krijuara është 1.428.586 lekë;
- paga si banakiere në lokalin “C”, në ish-Fushën e Aviacionit, në rrugën “A.L”, me administrator shtetasin B.P dhe më pas shtetasin V.P, për periudhën shtator 2001 – 2007 (nuk disponon dokumentacionin përkatës) dhe shuma e të ardhurave *neto* të krijuara është përafërsisht 1.000.000 lekë.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- vërtetimin nr. *** prot., datë 20.1.2017, nga ISSH-ja, në lidhje me të ardhurat e pensionit të pleqërisë të nënës S.B, për periudhën 8.5.2004 – 31.1.2017, në shumën totale 1.428.586 lekë.

Analiza financiare e subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003 – 2016

Vitet	Pasuri	Diferencë Likuiditeti	Detyrime	Pasuri neto	Të ardhura	Shpenzime	Rezultati financiar
2003	-	-	-	-	841 855	281 592	560 263
2004	250 000	-	-	250 000	1 170 823	281 592	639 231
2005	323 866	323 866	-	323 866	1 605 949	585 276	696 807
2006	955 891	955 891	-	955 891	1 649 417	547 785	145 741
2007	2 043 558	-956 442	-	2 043 558	1 884 631	974 522	-1 133 449
2008	-221 569	-221 569	-	-221 569	1 457 229	1 760 698	-81 901
2009	-97 510	-97 510	-	-97 510	1 674 077	1 083 100	688 487
2010	42 254	42 254	-	42 254	2 154 792	983 100	1 129 438
2011	1 915 499	255 899	691 500	1 223 999	2 273 494	826 475	223 020
2012	1 469 172	910 292	-416 320	1 885 492	2 485 484	986 394	-386 402
2013	587 458	587 458	-280 420	867 878	2 212 421	1 535 317	-190 774
2014	469 468	469 468	-	469 468	2 540 993	1 664 988	406 537
2015	817 793	817 793	-	817 793	2 554 819	2 061 421	-324 395
2016	-21 760	-21 760	-	-21 760	2 576 926	2 127 781	470 905
Rezultati financiar total për periudhën 2003-2016							-2 116 921

Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë

Nga vlerësimi i pasurisë në tërësi vërehet se subjekti nuk ka deklaruar saktë pasurinë dhe janë konstatuar elemente, që mund të ngrenë dyshime për fshehje të pasurisë. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të pamjaftueshme dhe rezultoi në mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e tyre, sikurse është specifikuar në pikat përkatëse ku janë analizuar pasuritë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, DSIK-ja ka dërguar një raport⁹⁰ në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar:

✓ *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ardian E Braho.*

Ky informacion është përditësuar nga DSIK-ja me shkresat nr. ***prot., datë 18.8.2021 dhe nr. *** prot., datë 30.8.2021, e cila ka konfirmuar se nuk disponon informacion shtesë për përfshirje të subjektit në veprimtari të kundërligjshme.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Pavarësisht konstatimit sa më sipër, Komisioni ka hetuar në lidhje me pastërtinë e figurës, duke i kërkuar informacion Prokurorisë së Përgjithshme për procedime të iniciuara ndaj subjektit të rivlerësimit, nga informacioni i ardhur ka rezultuar një procedim penal i vitit 2016, i regjistruar nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë. Ky procedim është iniciuar bazuar në pamjet

⁹⁰Raport me nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 12.12.2019, të KDZH-së.

televizive të transmetuara në datën 28.9.2016, nga emisioni investigativ “Stop” në televizionin Klan, lidhur me një situatë korruptive të kryer nga oficeri i policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në përfundim të veprimeve hetimore, në datën 26.1.2017, Prokuroria për Krimet e Rënda Tiranë ka vendosur pushimin e hetimit ndaj subjektit Ardian Braho, me cilësimin se “nuk u provua kryerja e veprës penale”.

Ky vendim është ankimuar nga subjekti Ardian Braho pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me kërkesën për ndryshimin e formulimit sa më sipër.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda në përfundim të gjykimit ka vendosur ndryshimin e vendimit të pushimit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda ndaj z. Ardian Braho me cilësimin se “i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale”.

Vlerësimi i Komisionit

- ✓ Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit ka rezultuar se subjekti ka plotësuar me vërtetësi dhe korrektësi këtë formular në përputhje me dispozitat urdhëruese të ligjit.
- ✓ Nga hetimi i kryer nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Ardian Braho ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter, është bazuar në analizimin e:

- raportit⁹¹ të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka miratuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike për përshkrimin dhe analizën e dokumenteve të vlerësimit profesional të subjektit Ardian Braho, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Raporti është bazuar në të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësive profesionale;
- b) aftësive organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

1. formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit;
2. pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
3. të dhënave nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

⁹¹Raporti nr. *** prot., datë 15.5.2020.

Formulari i depozituar nga subjekti rezulton i nënshkruar dhe i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti, në formularin e vetëdeklarimit, ka deklaruar një shifër të përgjithshme për tre vitet e fundit të çështjeve të caktuara, të përfunduara dhe të mbartura, pa iu referuar viteve, muajve dhe datave konkrete.

PËRSHKRIMI I PESË DOSJEVE PËR PROKURORIN ARDIAN BRAHO, TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

Nga verifikimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short nuk u konstatuan problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional.

Komisioni evidentoi zvarritje të hetimit për të cilat subjektit iu kërkua të japë shpjegime lidhur me dy dosjet penale, si vijon:

1. Komisioni analizoi dosjen përkatëse penale, për të cilën subjekti ka disponuar në datën 19.3.2014 me vendimin për pushimin e hetimeve në lidhje me procedimin penal nr. ***, datë 13.6.2016, për veprën penale “mashttrim kompjuterik” të parashikuar nga neni 143/b, i Kodit Penal, bazuar në kallëzimin penal të kryer nga shtetasi shqiptar F.Xh, administrator i shoqërisë “F. F” sh.p.k. me seli në Tiranë, e cila ushtron aktivitetin e importimit dhe eksportimit të produkteve të mishit dhe produkteve të tjera të ngrira.

Përmes vendimit të pushimit, prokurori ka argumentuar se për mungesë të provave dhe të përgjigjeve të ardhura me letërporosi nga autoritete të huaja gjyqësore, procedimi duhet të pushohet.

Gjatë hetimit, nga prokuroria janë kryer letërporosi drejtuar autoriteteve kompetente gjyqësore në territorin e Mbretërisë së Spanjës, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Indisë dhe të Nigerisë, ku janë kërkuar të dhëna financiare dhe elektronike për poseduesit e numrave të llogarive dhe posedueseve të IP përkatëse nga kanë ardhur mesazhet. Nga ana e këtyre autoriteteve gjyqësore nuk është kthyer përgjigje deri në momentin e vendimmarrjes së prokurorit.

Në këto kushte, kur nga veprimet hetimore nuk rezultuan të dhëna për ngritjen e akuzës, si dhe në kushtet kur edhe nga autoritetet kompetente gjyqësore të huaja nuk mbërritën prova, që në tërësinë e tyre do të provonin veprimet e kundërligjshme që do të përbënin bazë për marrjen në cilësinë e të pandehurit, në mbështetje të gërmës “b”, të pikës 1, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale prokurori vendosi pushimin e hetimeve.

Pas ardhjes së përgjigjeve nga autoritetet e huaja, me vendimin e datës 23.1.2015, të Drejtorit të Drejtorisë së Task-Forcës në Prokurorinë e Përgjithshme, është shfuqizuar vendimi i pushimit të procedimit penal nr. ***, i vitit 2013. Për ndjekjen e hetimeve të këtij procedimi penal, pas rifillimit, është caktuar prokuror E.M. Në datën 24.3.2017, mbështetur në nenin 326/1 të Kodit të Procedurës Penale, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur “pezullimi i hetimeve të procedimit penal nr. ***, viti 2013”.

Nga analizimi i dosjes penale sipas vlerësimit të KLP-së dhe Komisionit u evidentua se:

- a) Vonesa e hetimit të kësaj çështjeje prej 9 muaj e 6 ditë duket se është e justifikuar për shkak të moskthimit të përgjigjes nga autoritetet e huaja të drejtësisë, përgjigje që nuk kishin mbërritur në Prokurorinë Tiranë, deri në momentin e pushimit të procedimit.
- b) Nga analizimi i dosjes, subjekti duhet të kishte vendosur “pezullimin e hetimeve” deri në ekzekutim të letërporosisë dhe identifikimin e autorëve, në bazë të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale dhe jo pushimin e procedimit penal, për shkak të moskthimit të përgjigjeve nga autoritetet e huaja.

Subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me “pushimin e hetimit” të çështjes, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në lidhje me konstatimet e Komisionit subjekti ka pranuar se ky konstatim mbi shkakun e pushimit të çështjes penale, germa “dh”, e pikës 1, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale, është i drejtë dhe i bazuar në ligjin procedural penal, si dhe duhej të ishte konstatuar pushimi i çështjes penale për mungesë të të dhënave dhe provave për ngritjen e akuzës. Sipas shpjegimeve të tij, në atë kohë ishte vendosur një praktikë hetimore, pra ndërprerja e veprimeve hetimore nëpërmjet pushimit të hetimeve, për procedimet penale, ku veprimet hetimore kishin të bënin kryesisht me marrjen e të dhënave dhe provave të ndodhura në territorin e një shteti të huaj, nëpërmjet letërporosive. Për këto lloj procedimesh, fillimisht realizoheshin të gjitha veprimet hetimore të mundshme për marrjen e të dhënave dhe provave në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe, më pas, dërgoheshin letërporositë për marrjen e të dhënave dhe provave të ndodhura në territorin e shtetit të huaj.

Pas konstatimit të mungesës së të dhënave dhe provave të mbledhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, që do të çonin në ngritjen e akuzës ndaj një personi konkret dhe në mungesë të të dhënave të marra në ekzekutim të letërporosive të dërguara autoriteteve të huaja të drejtësisë, prokurorët vendosnin pushimin e çështjes penale.

Subjekti ka argumentuar, ndër të tjera, se kjo praktikë hetimore ishte vendosur duke marrë në konsideratë volumin e punës, kohëzgjatjen e ekzekutimit të letërporosisë, si dhe çështjen administrative të mbajtjes së procedimeve në sekretarinë e Prokurorisë dhe jo dërgimin tek shërbimet e policisë, për efekt të shpejtësisë së veprimeve në rast të ekzekutimit të letërporosive. Subjekti ka shpjeguar se praktika e mësipërme, në rastin e procedimit penal, nuk ka sjellë pasoja në respektimin apo cenimin e të drejtave të palëve të interesuara apo në zgjidhjen përfundimtare të çështjes penale, pavarësisht se çmon se konstatimi i Komisionit është i drejtë.

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni vlerëson se subjekti, në vendimmarrjen e tij, ndonëse ka analizuar dhe arsyetuar shkaqet e pushimit të procedimit penal, bazuar në normat e Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në përputhje me pikën 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, ka konkluduar përpara se të përfundonin veprimet hetimore të nisura. Përfundimisht, Komisioni vlerëson se ndonëse janë konstatuar mangësi në veprimet e subjektit, kjo rrethanë çmohet e pamjaftueshme për ta konsideruar subjektin me aftësi profesionale poshtë nivelit minimal të kërkuar nga germa “c”, e nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, për kualifikimin e subjektit.

2. Komisioni analizoi dosjen penale, ku subjekti në datën 25.3.2016, ka disponuar me vendimin “për pushimin e hetimeve në lidhje me procedimin penal nr. *, datë 6.11.2014”.**

Procedimi penal nr. *** konsiston në veprën penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën” të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, mbi bazën e kallëzimit të kryer nga shtetasi G.M ndaj shoqërisë “CEZ Shpërndarje”, pasi ka rezultuar debitor në vitet 2012 dhe 2013, edhe pse kishte likuiduar detyrimet e tij ndaj kësaj të fundit.

Me anë të vendimit të pushimit, subjekti ka argumentuar se nuk ka prova të ndonjë vepre penale të parashikuar si të tillë nga Kodi Penal dhe, për këtë arsye, hetimet për procedimin penal duhet të pushohen. Rezultoi se ndaj vendimit të pushimit nuk është bërë ankim.

Nga verifikimi i dosjes penale ka rezultuar se:

- a) Kohëzgjatja e këtij procedimi penal ka zgjatur 1 vit, 4 muaj, 20 ditë, ku evidentohet zvarritja e hetimit pa shkak për gati 11 muaj⁹² deri në momentin e pushimit të çështjes.
- b) Çështja nuk ka autor të regjistruar, megjithëse subjekti i kishte të gjitha mundësitë për të identifikuar personin që i atribuohet vepra penale.

Në lidhje me konstatimin sa më sipër, subjektit iu kërkuan shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në lidhje me zvarritjen e hetimit, subjekti ka shpjeguar se ka respektuar afatet kohore për regjistrimin e procedimit penal, urdhërimin dhe delegimin me shkrim për kryerjen e veprimeve hetimore për oficerin e policisë gjyqësore, që përbën një nga detyrat kryesore funksionale të prokurorit.

Subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se cilat kanë qenë përparësitë e tij në ushtrim të funksionit të prokurorit, të cilat konsistojnë kryesisht në: (i) ushtrimin e ndjekjes penale përmes studimit të çdo materiali kallëzues; (ii) evidentimin e elementeve të veprës penale në faktet e pretenduara apo të referuara në materialin kallëzues; (iii) përcaktimin e një kohe sa më të shpejtë të regjistrimit të procedimit penal apo mosfillimit të hetimeve; (iv) fillimin e ushtrimit të ndjekjes penale, nëpërmjet urdhërimit dhe delegimit të kryerjes së veprimeve hetimore nga oficeret e policisë gjyqësore, duke përcaktuar një afat kohor të arsyeshëm për kryerjen e tyre, në varësi të veprimeve dhe natyrës të tyre.

Subjekti argumenton se në të gjitha procedimet e hetuara, përfshirë edhe procedimin penal në fjalë, i ka dhënë prioritet zgjidhjes sa më të drejtë ligjore dhe të bazuar objektit të hetimit dhe njoftimit të palëve të interesuara, duke vënë në raport, veçanërisht, cilësinë e hetimit, shterimin e hetimeve, si dhe përfundimin e hetimeve bazuar në prova dhe në ligjin procedural penal dhe ligjin penal.

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, lidhur me zvarritjen e veprimeve hetimore, pavarësisht faktit se çështja nuk ka autor të regjistruar, vlerëson se këto shkaqe nuk justifikojnë këtë zvarritje, pasi është detyrë e prokurorit që të marrë të gjitha masat e nevojshme për përfundimin e veprimeve hetimore në një kohë sa më të shkurtër.

Përfundimisht, lidhur me këtë pikë, u konkludua se përpos sa është konstatuar më lart, parë në përputhje me germen "a", të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, subjekti, në tërësi, ka treguar cilësi në masë të pranueshme në aspektin profesional.

TË DHËNAT ARKIVORE LIDHUR ME ANKESA, MASA DISIPLINORE DHE VLERËSIME

Nga verifikimi në arshivën e Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton që prokurori Ardian Braho me detyrë prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.*** datë 03.10.2016, është pezulluar nga ushtrimi i detyrës deri në përfundim të procedimit penal nr.*** të vitit 2016, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Pas hetimeve të kryera, është vendosur pushimi i hetimeve për z. Braho, dhe me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. ** datë 15.02.2017 është rikthyer në detyrën e prokurorit në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

⁹²Periudha prill 2015 - mars 2016, kur është vendosur pushimi i procedimit.

ANALIZA E GJETJEVE⁹³

Sipas kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” nga analizimi i 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short ka rezultuar se:

1. Aftësitë profesionale

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara rezulton se prokurori Ardian Braho, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit.

Nga dosjet e vëzhguara konstatohet se ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret dhe identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme. Kështu, menjëherë, pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre.

Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014, 2015 dhe 2016, rezulton se për aftësitë profesionale, në cilësinë e prokurorit, është vlerësuar “shumë mirë”.

Arsyetimin ligjor e mbështet jo vetëm në normat penale, por edhe në normat sipas specifikave të hetimeve që ka kryer.

2. Aftësitë organizative

Për periudhën e vlerësimit tetor 2013 - tetor 2016 rezulton se nga prokurori Ardian Braho tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara.

Në analizë të të dhënave në këto dosje, konstatohet se subjekti Ardian Braho ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuara dhe numrit total të çështjeve të përfunduara për të gjithë periudhën e vlerësimit.

Prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara, janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Nga dosjet e vëzhguara ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

Nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Ardian Braho. Nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Nga dosjet e vëzhguara vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë. Ka aftësi për të bashkëpunuar me kolegët, pasi në një procedim penal subjekti ka qenë i

⁹³Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

ngarkuar për hetimin e tij me grup prokurorësh. Subjekti ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

Denoncimet e ardhura në Komision për subjektin e rivlerësimit Ardian Braho u analizuan, ku në katër prej tyre, nuk u evidentuan problematika pasi nuk përmbanin fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Lidhur me 3 denoncimet ku ngrihen pretendime për zvarritje të hetimit, Komisioni, pasi analizoi dosjet penale përkatëse të ardhura nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka evidentuar zvarritje të hetimit dhe mungesë veprimesh hetimore, për të cilat subjektit iu kërkua të japë shpjegime lidhur me denoncimet në vijim:

1. Denoncim⁹⁴ nga shtetasi z. A. S

Ky shtetas pretendon se subjekti: (i) ka nxjerrë nga burgu përmbanuesin, z. B. N, pa vendim gjykatë; (ii) ka ankimuar padrejtësisht vendimin në Gjykatën e Apelit; (iii) ka zvarritur hetimin për procedimin penal nr. ***, të vitit 2017; (iv) denoncon 2 prokurorë, ndër të cilët edhe z. Ardian Braho, se kanë kryer shkelje profesionale pasi nuk e ka marrë në pyetje denoncuesin sipas ligjit; etj.

Lidhur me procedimin penal nr. ***, të regjistruar në datën 10.5.2017, për të cilin subjekti Ardian Braho në datën 28.7.2017 ka vendosur “mosfillimin e procedimit penal” duke e konsideruar çështjen si “gjë të gjykuar” për shkak të një procedimi tjetër penal nr. ***, të vitit 2016, i bashkuar, i cili përmban të njëjtin objekt, palë dhe pretendime dhe prokurori i asaj çështjeje ka vendosur “pushimin e hetimit”.

Ky vendim i subjektit “për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, viti 2017” është shfuqizuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁹⁵ në datën 1.11.2017 dhe nga Gjykata e Apelit Tiranë⁹⁶ në datën 5.2.2018, si rezultat i veprimeve verifikuese jo të plota nga organi i Prokurorisë.

Në datën 21.3.2018 prokurori ka regjistruar sërish procedimin penal nr. ***, të vitit 2018, për të kryer hetime të mëtejshme dhe, në përfundim të hetimit, z. Ardian Braho, në datën 30.5.2019, i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë “pushimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2018”, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. *** akti, datë 22.1.2020. Çështja gjyqësore është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë në datën 5.2.2020, që do të thotë se është në shqyrtim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera se, duke qenë se e njëjta çështje me të njëjtat fakte dhe kallëzues ishte duke u hetuar nga prokurori N. T (bëhet fjalë për procedimin penal nr. ***, të bashkuar), me qëllim të mosregjistrimit fiktiv të një

⁹⁴(1) formular i denoncimit nga publiku me nr. *** prot., datë 5.12.2017; (2) formular i denoncimit nga publiku me nr. *** prot., datë 8.1.2018; (3) denoncim me nr. *** prot., datë 4.4.2019, i përcjellë nga institucioni i Komisionerit Publik me shkresën nr. *** prot., datë 4.4.2019; (4) denoncim me nr. *** prot., datë 5.4.2019, i përcjellë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit me shkresën nr. *** prot., datë 4.4.2019; (5) denoncim me nr. *** prot., datë 19.8.2019, i përcjellë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit me shkresën nr. *** prot., datë 16.8.2019; (6) denoncim me nr. *** prot., datë 9.2.2021, i përcjellë nga Institucioni i Komisionerit Publik me shkresën nr. *** prot., datë 9.2.2021; (7) denoncim me nr. *** prot., datë 11.2.2021, i përcjellë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit me shkresën nr. *** prot., datë 11.2.2021.

⁹⁵Me vendimin nr. ** regj. them., datë 1.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁹⁶Me vendimin nr. ***, datë 5.2.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

procedimi penal, ka pritur vendimmarrjen e prokurorit në fjalë, gjë e cila ka sjellë si pasojë edhe kalimin e afatit ligjor për trajtimin e materialit kallezues.

Subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se në momentin e regjistrimit të procedimit penal nr. ***, datë 21.3.2018, ndodhej përpara një fakti ku Gjykata e Apelit Tiranë nuk ishte shprehur në lidhje me procedimin penal nr. ***, të vitit 2016, të bashkuar, të hetuar nga prokurori N.T, i cili kishte vendosur pushimin e çështjes. Në të gjitha rastet e trajtuara për këtë çështje, subjekti është kujdesur që të mos gjendet në kushtet e hetimit të të njejtave fakteve, të cilat janë apo kanë qënë objekt të gjykimeve nga gjykata.

Për të provuar se e njëjta situatë juridike ka ndodhur edhe më pas, me të njëjtin kallëzues, z. A. S, subjekti ka depozituar një vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁹⁷ përmes së cilës provohet se e njëjta çështje është hetuar edhe nga prokurorë A.Q, e cila, në datën 19.10.2018, ka disponuar me vendim për pushimin e hetimit, e pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. ***, datë 11.2.2019.

Mosorganizimi në shkallën e duhur të regjistrimit të kallëzimeve apo padive në sekretarinë e Prokurorisë apo në Gjykata, ka sjellë si rezultat një pështjellim në hetimin dhe shqyrtimin e fakteve të pretenduara nga kallëzuesi, duke sjellë për pasojë një pasiguri juridike si për kallëzuesin ashtu edhe për të kallëzuarin dhe, në disa raste, përballjen me rastin e gjësë së gjykuar.

Sa i takon pretendimit të denoncuesit për lirimin nga burgu të përmbaruesit gjyqësor B.N, subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se: *“Nga studimi i materiali kallëzues nga ana ime është konstatuar se shërbimet e policisë gjyqësore kishin ndaluar me iniciativen e tyre z. B.N, në kundërshtim me ligjin procedural penal dhe, për këtë arsye, në datën 29.10.2015 kam urdhëruar lirimin e menjëhershëm të këtij shtetasi”*. Subjekti ka provuar⁹⁸ se urdhri i tij është konsideruar i bazuar në dispozitat ligjore nga Drejtoria e Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale në Prokurorinë e Përgjithshme.

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti në prapësime, duke i konsideruar ato bindëse. Gjithashtu, duke qënë se çështja është e ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, nisur nga ky fakt, në këtë rast nuk janë konstatuar shkelje të subjektit.

2. Denoncimi⁹⁹ i shtetasit B. B

Shtetasi ka paraqitur denoncime për tri subjekte rivlerësimi, ndër të cilët, edhe z. Ardian Braho me pretendimin se ka zvarritje në hetimin e çështjes së tij, për më shumë se 33 muaj.

Lidhur me këtë denoncim, Komisioni i ka kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dosjen e këtij procedimi penal, për të verifikuar pretendimet e denoncuesit mbi zvarritjen e çështjes.

Nga analizimi i dosjes penale¹⁰⁰ evidentohet se procedimi penal nr. *** është regjistruar në datën 23.7.2014 dhe ka përfunduar më 30.3.2017 me vendimin për pushimin e hetimeve. Veprimet hetimore të kryera nga subjekti konsistojnë në periudhën korrik 2014 – tetor 2016¹⁰¹.

⁹⁷Vendim nr. ** regj., datë 11.2.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i depozituar nga subjekti me prapësimet e datës 19.10.2021.

⁹⁸Shkresë me nr. *** prot., datë 12.11.2015, e depozituar nga subjekti me prapësimet e dates 19.10.2021.

⁹⁹Denoncimet: nr. *** prot., datë 16.1.2018 dhe nr. *** prot., datë 23.1.2018.

¹⁰⁰Mbërritur me shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁰¹Subjekti është pezulluar nga detyra me urdhrin nr. ***, datë 3.10.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm për shkak të procedimit penal të trajtuar te rubrika e kontrollit të figurës (faqet 48-49 e vendimit).

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Lidhur me konstatimin e Komisionit për mungesën e vendimeve të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimit, subjekti ka shpjeguar se është atribut i prokurorit të çështjes regjistrimi i emrit të personit, të cilit i atribuohet vepra penale, mbështetur në nenin 287 të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se për shkak të kalimit të konsiderueshëm të afatit kohor të shqyrtimit të materialit kallëzues, rezultonte e domosdoshme kryerja e veprimeve hetimore, që kishin të bënin me hetimin e faktit kriminal, ndër të tjera, edhe këqyrja e vendit të ngjarjes. Nisur nga ky fakt, mbështetur në nenet 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale, nuk është në kushtet e vendimmarrjes së prokurorit në lidhje me zgjatjen e afatit të hetimit.

Sa i takon vonesës në kryerjen e veprimeve hetimore, subjekti ka shpjeguar se kjo ka ndodhur për shkak të angazhimit në ushtrimin e funksionit të prokurorit dhe oficerëve të policisë gjyqësore edhe për procedime penale të tjera, si dhe për shkak të largimit apo transferimit në mënyrë të vazhdueshme dhe të shpeshtë të oficerëve të policisë gjyqësore, për të cilën ka ardhur në dijeni në momentin e njoftimit, si dhe për shkak të moskthimit të përgjigjeve nga dy institucione shtetërore si ZVRPP-ja Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban të Bashkisë Tiranë, përgjigje të cilat janë kthyer përgjatë vitit 2016.

Vetëm në momentin kur dosja është kthyer administrativisht pranë prokurorisë dhe pasjes fizikisht të fashikullit të procedimit penal, është konstatuar prej tij se nuk ishin kryer veprimet hetimore të urdhëruara dhe të deleguara për t'u kryer nga oficerët e policisë gjyqësore. Sipas subjektit, këto rrethana kanë ndikuar edhe në zvarritjen e hetimit, si dhe në kryerjen e plotë të veprimeve hetimore.

Vlerësimi i Komisionit

Në prapësime, subjekti shpjegoi arsyet që kanë shkaktuar vonesën e hetimit të çështjes për shkaqe të arsyeshme sipas tij, por Komisioni vlerëson se ato qëndrojnë vetëm pjesërisht, pasi ngarkesa e punës dhe zëvendësimi i oficerëve të policisë gjyqësore nuk mund të justifikojë vonesa kaq të gjata, pasi është detyrë e prokurorit organizimi dhe mbikëqyrja e kryerjes apo jo në kohë e hapave hetimorë. Megjithatë, Komisioni vlerëson se ndonëse janë konstatuar edhe në këtë rast vonesa në veprimet hetimore, kjo rrethanë çmohet e pamjaftueshme për ta konsideruar subjektin me aftësi profesionale nën nivelin minimal të kërkuar nga germa “c”, e nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, për kualifikimin e subjektit.

2. Denoncim i shtetas H. S¹⁰²

Shtetasja ka depozituar një denoncim ndaj subjektit të rivlerësimit Ardian Braho, me pretendimin se ka mbajtur dosjen për më shumë se 1 vit, lidhur me një kallëzim penal të ngritur ndaj kryeinspektorit i Inspektoratit Urbanistik Vendor Tiranë, për veprën penale “shpërdorim të detyrës” dhe “ndërtim të paligjshëm”, parashikuar nga nenet 199/a/2 dhe 248 të Kodit Penal.

Lidhur me këtë denoncim, Komisioni ka administruar dosjen e procedimet penal¹⁰³ për të verifikuar pretendimet e denoncuesit.

Komisioni, nga verifikimi i dosjes penale, ka evidentuar se procedimi penal nr. *** është regjistruar më 21.10.2013, nga prokurori i çështjes Ardian Braho, i cili në përfundim të veprimeve hetimore, në datën 20.11.2014, ka vendosur pushimin e hetimit.

¹⁰²Formulari i denoncimit nga publiku me nr. *** prot., datë 22.11.2017, paraqitet nga shtetasja A. L, vajza e denoncueses H. S.

¹⁰³Me shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësimet e depozituara më 19.10.2021, subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se veprimet hetimore të urdhëruara dhe të deleguara pranë oficerit të policisë gjyqësore i përkasin periudhës 30.10.2013 – 10.11.2014, veprime hetimore që kanë të bëjnë me dokumentimin nga ana shkresore të veprimeve të punonjësve të INUV, Bashkisë Tiranë, identifikimin dhe pyetjen e këtyre të fundit, gjithashtu edhe faktin se shtetasi i kallëzuar A. K nuk është gjetur në banesë dhe më pas në kohë është bërë i mundur identifikimi dhe më pas pyetja e tij, si dhe marrja e dokumentacionit të nevojshëm.

Subjekti ka ritheksuar se prioritet në ushtrimin e funksionit të tij ka qenë trajtimi ligjor i materialeve kallëzuese, urdhërimi dhe delegimi i kryerjes së veprimeve hetimore të detajuara në një kohë sa më të shpejtë, si dhe përfundimi i çështjes në një zgjidhje ligjore të drejtë dhe të bazuar në prova dhe në ligjin penal dhe procedural penal.

Në lidhje me veprimet e punonjësve të INUV-së, të Bashkisë Tiranë, subjekti ka shpjeguar se ishte shumë e vështirë të provonte dashjen direkte në mosveprimet e punonjësve të kësaj zyre, duke shpjeguar se vendimmarrja nga ana e tij nuk është nisur në e asnjë rast për favorizimin e punonjësve të zyrës së sipërcituar, pasi, sikundër është pasqyruar edhe në raportin e Komisionit në vitin 2014, subjekti ka dërguar për gjykim kryeinspektorin e INUV-së dhe disa inspektorë të kësaj zyre, duke aplikuar masa sigurimi personale në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, si dhe disa qytetarë për veprën penale “ndërtim të paligjshëm, gjykime që kanë përfunduar me deklarinimin fajtor të këtyre të fundit”.

Vlerësimi i Komisionit

Në prapësime, subjekti shpjegoi qartë arsyet që kanë shkaktuar vonesën e hetimit të çështjes, e cila ka rezultuar për shkaqe të arsyeshme dhe, përfundimisht, u vlerësuan se ishin bindëse dhe të provuara, referuar akteve të administruara në dosjen penale.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se pavarësisht problematikave të konstatuara, në një vlerësim tërësor të këtij kriteri, ka arritur së paku nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes mbi të tria kriteret e rivlerësimit, mbështetur në provat e administruara nga Komisioni në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej tij, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti t’i provojë trupit gjykues të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me kriterin e pasurisë.

Subjekti nuk provoi bindshëm: (i) burimet e ligjshme financiare për krijimin e pasurive në disponim/pronësi të personit të lidhur, babait të subjektit – duke tentuar të evitojë verifikimin dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pamjaftueshmëria financiare, duke pretenduar se ato nuk ishin shuma monetare të familjes së tij, por të tezes, pa arritur ta provojë këtë rrethanë; (ii) pamundësinë financiare me burime të ligjshme të subjektit dhe të familjes së tij të për të justifikuar: (a) depozitën e shumës 20.000 euro, në datën 7.5.2007, si dhe blerjen e apartamentit në datën 16.8.2007; (b) shpenzimet dhe investimet, ndër vite, në pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo gjendje/depozita bankare, sikurse është pasqyruar në tabelën e përgjithshme të

analizës financiare – duke u gjendur në parashikimet e pikave 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a”, “b” dhe “c” të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në përputhje me pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ardian Braho, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 1.11.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)
Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore/Kundër

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha